

**RAPORT**

**I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Për Programin e studimit Master Profesional në**

**Politika të Zhvillimit të Territorit**

**me profile:**

1. Planifikim hapësinor dhe aplikime GIS
2. Strehim dhe Zhvillim Toke
3. Zhvillim social urban dhe burime njerëzore

**Universiteti POLIS**

Eksperti i vlerësimit të jashtëm:

**Prof.As. Gafur Muka**

**Dr. Gjergj Thomai**

Janar 2019

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master Profesional në “Politika të Zhvillimit të Territorit”, me profile:

1. Planifikim hapësinor dhe aplikime GIS
2. Strehim dhe Zhvillim Toke
3. Zhvillim social urban dhe burime njerëzore

Tabela e të dhënave për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Polis
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	- Licensuar me VKM Nr. 406, datë 26.05.2010 - Riorganizuar me UMAS Nr. 431, datë 11.11.2015, ndryshuar me UMAS Nr. 465, datë 02.12.2015
4	Urdhëri i akreditimit:	- Akredituar me Urdhër Nr. 250, datë 14.06.2013. - Njohur vlefshmëria me Urdhër Nr. 216, datë 08.05.2017
4	Titulli i programit të studimit:	Master Profesional në “Politika të Zhvillimit të Territorit”, me profile: “Planifikim hapësinor dhe aplikime GIS”, “Strehim dhe Zhvillim Toke”, “Zhvillim social urban dhe burime njerëzore”
5	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
7	Kreditet në total (ECTS):	90 ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të pjesshme
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip/Anglisht
10	Programi ofrohet nga institucioni	Universiteti Polis
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Në bashkëpunim me IHS – Institute for Housing and Urban Studies / Erasmus University, Hollandë
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Po
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
15	Numri i studentëve (2017-2019): “Planifikim Hapesinor & Aplikime GIS” “Strehim dhe zhvillim toke” “Zhvillim social urban dhe burime njerezore”	56 studentë 12 studentë 20 studentë <b>88 studentë</b>
	etj	

## HYRJE

### Të dhëna për programin e studimit

Programi i studimit Master Profesional “Politikat e zhvillimit të territorit” është një program i ciklit të dytë, me kohëzgjatje dy vjet me kohë të pjesshme, me 90 ECTS në përfundim të të cilit lëshohet diplomë:

Master Profesional “Politikat e zhvillimit të territorit” me tre profilet: a) Planifikim hapësinor dhe aplikime GIS, b) Strehim dhe Zhvillim Toke, c) Zhvillim social dhe burime njerëzore.

Baza ligjore e hapjes (fillimisht si Mastera të Nivelit të Dytë) dhe më pas përshtatjes së programit (në Master Profesional në përputhje me ndryshimet ligjore) është përshkruar në mënyrë të detajuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, shoqëruar dhe me dokumentacionin përkatës dhe mund të përmbliidhet në:

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 406, datë 26.05.2010; Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 557, datë 09.12.2010 “Për lejimin për ushtrimin e veprimtarisë akademike në përputhje me licensën e dhënë për hapjen e programeve të reja të studimit shkollës së lartë Private POLIS”, Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 588, datë 20.12.2010 “Për miratimin e riorganizimit të programeve të studimit të shkollës së lartë private Universiteti POLIS”; më 2015 programi është riorganizuar nga 3 programe të ndryshme në një program me tre profile në përputhje me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 431, datë 11.11.2015, ndryshuar me Urdhërin Nr. 465, datë 03.12.2015. Me Urdhërin Nr. 216, datë 08.05.2017 të MAS është njohur vlefshmëria e akreditimit për programet e studimit të riorganizuara, sipas akreditimit të mëparshëm në Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 250, datë 14.06.2013.

Ky program ka statusin e një programi të përbashkët studimi pasi ofrohet në bashkëpunim mes Universitetit POLIS dhe IHS – Institute for Housing and Urban Studies / Erasmus University, Hollandë.

Në vitin e parë akademik të këtij programi 2011-2012 u regjistruan 28 studentë në të tre profilet e Masterave, ndërsa në vitin 2017-2018 janë regjistruar 52 studentë në të tre profilet. Ky është një tregues për konsolidimin dhe qëndrueshmërinë e programit.

### GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën:

Prof. As. Gafur Muka dhe Dr. Gjergj Thomai ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Koordinatore Teknike e ASCAL për këtë programi studimi është Zj. Ersi Dako.

Më datë 18.01.2019, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm i hartuar nga ekspertët e vlerësimit. Më datë 18.01.2019, Institucioni, me shkresë Nr. 60/19 Prot., kthen përgjigje në formë zyrtare, në të cilën shprehet se nuk ka komente për të. Sa më lart, Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

# ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

## I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit për të tre profilet:

- a) Të plotësohet: standardi lidhur me raportin e PAE/PAK të kërkuar për këtë program studimi.
- b) Të konkretizohet fryma e interesimit për kualifikimin e personelit akademik me plane të detajuara dhe detyra me afate konkrete.
- c) Të rregullohen mospërputhjet për të dhënat e personelit akademik të huaj pasi kjo gjë e përkeqëson raportin PAE / PAK.
- d) Të realizohet sa më shpejt pajisja me pajimet e planifikuara për njësinë kërkimore të qëndrueshmërisë (sust\_lab).
- e) Të bëhet përpjekje për ti raportuar, edhe në mënyrë të detajuar, të gjithë treguesit në plotësim të kërkesave të standardeve për auditin financiar sipas formatit të kërkuar për akreditimin programor të këtij programi studimi.
- f) Të përfshihen në planin mësimor lëndë/module të hartografisë dhe gjeostatistikës për të mos krijuar boshllëqe lidhur me kuptimet dhe përdorimet e GIS-it. Kjo përfshirje do të ndihmonte edhe realizimin e aplikimeve në GIS të programuara në syllabusin e lëndës/modulit "Studio Planifikimi" dhe të nevojshme (përkatësisht domosdoshme) në realizimin e "Praktikës Profesionale" dhe "Tezës së Diplomës".
- g) Të realizohet evidenca sasiore e krediteve plotësuese për programet e përafërta në kriteret e pranimit të studentëve për të rritur kontigjentet e kandidatëve që duan të frekuentojnë këtë program studimi.
- h) Të plotësohet raporti i vlerësimit të brendshëm me informacione lidhur me programet Bachelor që ofron institucioni në kuptimin e ruajtjes së vijimësisë së kurrikulave brenda institucionit.
- i) Të realizohet një "zë" pak më i ndjeshëm i Këshillit Studentor në shërbim të Njësisë së brendshme të sigurimit të cilësisë.
- j) Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

## II. Plotësimi i tyre nga Universiteti POLIS:

- a) Për rekomandimin e pikës a, pas vizitës së kryer në institucionin përkatës rezultonte një raport i mirë i personelit akademik në këtë program studimi i përbërë nga 19 staf akademik me kohë të plotë dhe 6 staf me kohë të pjesshme, për një raport PAE/PAK 76% me 24%, gjë që qëndron në përputhje me standardet e kërkuara.
- b) Rekomandimi i pikës b, institucioni mbështet kualifikimin e stafit akademik, trajnimet dhe kualifikimet pas universitare, si instrumenta të rëndësishme për rritjen profesionale të stafit. Institucioni mbështet plotësimin me grada shkencore dhe tituj akademik përmbajtësor, personelin akademik. Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentave të marra nga ta, stafi inkurajohet dhe drejtohet për të kryer studimet e doktoraturës dhe marrjen e gradës Doktor, falë dhe programit të përbashkët PhD në Arkitekturë dhe Planifikim Urban të ofruar si double degree me një nga universitetet e mira në Europë, Universiteti i Ferrarës. Gjithashtu rezultoi se kualifikimet e mëtejshme realizohen nëpërmjet bashkëpunimeve ndërkombëtare që U\_POLIS ka në fushën specifike të planifikimit por dhe me gjerë, nëpërmjet antarësimit të kësaj shkolle në rrjetet më prestigjioze të shkollave të Planifikimit (anëtare e AESOP - Association of European Schools of Planning), dhe sigurisht nëpërmjet kalimit të informacionit nga stafi me më shumë eksperiencë tek ai më i ri.
- c) Universiteti POLIS paraqet qartë të dhënat për personelin e këtij programi (kreu 3), ku identifikohet stafi shqiptar, ai i huaj si dhe stafi efektiv i angazhuar me kohë të plotë në 2 institucionet që e bashkëofrojnë programin si dhe stafi me kontratë, duke krijuar një raport të mirë të PAE/PAK, 76% me 24%.
- d) Për rekomandimin e pikës d, Universiteti POLIS, në përputhje me objektivin e tij për pasurimin e vazhdueshëm të laboratorëve me pajisje dhe teknologji të reja ka investuar dhe vazhdon të investojë për plotësimin e Labororit të posaçëm Sust\_Lab. Këto investime pasqyrohen dhe janë raportuar dhe në MASR dhe ASCAL nëpërmjet raporteve vjetore, (raportit të vlerësimit të brendshëm për akreditimin institucional gjatë 2016, gjatë akreditimit institucional me QAA në 2017, raporteve të posaçme të kërkuara nga MASR si "Formulari i Vlerësimit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor" dhe kapacitetet pritëse). Gjithashtu infrastruktura e vënë në dispozicion për këto programe ka qenë dhe subjekt i verifikimit fizik gjatë vizites së akreditimit institucional si dhe vizitës së përvitshme për verifikimin e kapaciteve pritëse.

- e) Për rekomandimin e pikës e, rezulton se institucioni ka kryer monitorim të jashtëm për aktivitetin financiar të institucionit kryer nga kompanitë ndërkombëtare më të njohura në fushën e auditimit dhe raportimit financiar. Çdo vit raporti i pasqyrave financiare vjetore i nënshtrohet kontrollit sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit. Për të dokumentuar këtë skanim në përfundim të procesit të auditimit kompania e auditimit harton raportin përkatës i cili i bashkëngjitet dokumentave financiare. Raporti i fundit i auditit financiar gjendet në Aneks 20 të RVB.
- f) Ky rekomandim është reflektuar në kurrikulën e programit ku për profilin GIS është shtuar një laborator specifik dhe gjatë vitit të dytë. Plani mësimor me të dhëna të detajuara për të gjithë modulet gjendet në Aneks 24. Kurrikula është miratuar nga Dekani dhe Senati Akademik.
- g) Të dhëna të detajuara për kriteret e pranimit në këtë program studimi ndodhen në aneksin 3 të RVB.
- h) Ky program studimi falë profileve që ofron mund të konsiderohet si vazhdim i studimeve të ciklit të parë të atyre programeve të cilët japin formime me bazë të gjerë në fushën e planifikimit, urbanistikës, arkitekturës, gjeoinformatikës, etj. dhe krijon mundësi për specializime në planifikim hapësinor e të dhëna GIS, strehimit, administrimit publik dhe politikave sociale. Aktualisht POLIS ofron programe Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” dhe “Studime Mjedisore” si dhe programe të integruara të ciklit të dytë në “Arkitekturë dhe Dizajn Urban” dhe “Planifikim dhe Menaxhim Urban”, studentët e të cilëve mund të ndjekin në vijim programin Master Profesional në “Politika të Zhvillimit të Territorit”.
- i) Roli i Senatit Studentor dhe masa e përfaqësimit të tyre në organet kolegjiale ka ardhur në rritje. Studentët në Universitetin POLIS janë të përfaqësuar në masën 16% (3/19) në Senatin Akademik dhe si pjesë e NJBSC krahas 1 anëtari që ka qenë në 2013, sot ka edhe 1 përfaqësues nga komuniteti i ALUMNI, pra 22.2%.
- j) Për të regjistruarit deri në hyrjen në fuqi të Ligjit 80/2015 dhe Udhëzimi Nr.52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në Institucionet e Arsimit të Lartë”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.11, datë 30.06.2016 e më tej me Udhëzimin Nr. 11, datë 10.04.2017, Universiteti POLIS ka lëshuar diplomat për këtë program vetëm pas dorëzimit nga ana e studentit të dokumentit të njohjes së gjuhës angleze. Ndërkohë pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit në 2015 njohja e gjuhëve të huaja është tashmë kriter pranimi (pra kriter hyrës).

## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit ka një fokus të posaçëm në politikat e zhvillimit të territorit, që përbëjnë një aspekt shumë të ndjeshëm për Shqipërinë, parë dinamikën e zhvillimit urban në vend dhe problematikën që i ka shoqëruar si dhe mungesën e kapaciteteve profesionale për adresimin e tyre.

Programi i studimit është i organizuar me tre profile të ndryshme dhe si i tillë krahas objektivave të përgjithshëm për formimin e studentëve, ai ka dhe objektiva specifike për secilin profil, si vijon:

Objektiva të përgjithshme:

- T'u sigurojë studentëve një bazë të mirë teorike mbi politikat e zhvillimit urban dhe territorial, politikat dhe instrumentete e zhvillimit të tokës si dhe praktikën mjedisore lokale.
- T'u sigurojë studentëve njohuri themelore dhe të specializuara për analizimin, kuptimin dhe zgjidhjen e çështjeve të planifikimit dhe të menaxhimit.
- Të përgatisë studentët me njohuri teknike, praktike e shkencore sipas profileve të zgjedhura; Planifikim hapësinor dhe aplikime GIS, Strehim dhe Zhvillim toke ku përfshihet edhe vlerësimi i pasurive të patundshme, si dhe profili Zhvillim social dhe burime njerëzore.
- Të sigurojë një profil profesional që mund të thellohet në studime ose kërkime shkencore të mëtejshme, ose ndihmon të kualifikuarit në këtë program master të ripozicionohen në treg.

Objektiva specifike:

- *"Planifikim hapësinor dhe aplikime GIS"* ka si qëllim aftësimin praktik për të kryer analiza territoriale përmes teknologjisë/softëare GIS (Geographical Information Systems) në kontekste të ndryshme të territorit, për të prodhuar statistika hapësinore, harta dhe vizualizime gjeografike me qëllim aplikimin e tyre në planifikimin urban, rajonal, mjedisor si dhe planifikimin e transportit, etj.
- *"Strehim dhe Zhvillim Toke"* ka si qëllim aftësimin e studentëve për të analizuar instrumentat e tokës, infrastrukturës, dhe pasurive të patundshme (real-estate) në dimensione të ndryshme: që nga aspektet ekonomike, ligjore, financiare dhe sociale, e deri tek qëndrueshmëria, efica, etj. Studentët do të marrin instrumentat e nevojshëm për njohjen dhe vlerësimin e tregut të pasurive të patundshme, të financave lokale, për të operuar në sektorin e strehimit dhe vlerësimit të pasurive të patundshme, etj.
- *"Zhvillim social dhe burime njerëzore"* ka si qëllim aftësimin e studentëve për të analizuar sfidat kryesore të kohës për shoqërinë, sidomos në qendrat e mëdha urbane dhe me fokus çështjet kryesore që lidhen me politikat e burimeve njerëzore në shoqëri dhe institucione, sidomos në sektorin publik dhe privat; për të kuptuar ndikimin në performancën e këtyre sektorëve, si dhe shërbimeve dhe politikave të oftuara prej tyre në fushën e planifikimit të territorit dhe qeverisjes së mirë në tërësi. Ky specializim bazuar në potencialin e madh që kanë burimet njerëzore si aset zhvillimi ekonomik-social dhe qeverisjen e mirë, synon aftësimin e studentëve/profesionistëve për të menaxhuar problemet sociale në një territor të caktuar, veçanërisht për ata që operojnë në fushat e politikave të territorit duke trajtuar probleme si varfëria, kriminaliteti, marxhinalizimi, informaliteti, asistencë sociale, etj.

Sa më sipër janë përcaktuar në Rregulloren e Programit të Studimit.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve <sup>1</sup>
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	

<sup>1</sup> GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Bazuar në raportin e vlerësimit të brendshëm, anekset që i bashkëngjiten këtij raporti, vizitës në terren dhe kontrollit të dokumentacionit rezulton se Programi i studimit Master Profesional “Politikat e zhvillimit të territorit” më tre profile</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Planifikim hapësinor dhe aplikime GIS</li> <li>2. Strehim dhe Zhvillim Toke</li> <li>3. Zhvillim social urban dhe burime njerëzore</li> </ol> <p>është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit. Veprimtaritë formuese, sipas të cilave është organizuar programi i studimit, kanë objektivin e krijimit të ekspertëve të kualifikuar në fushat e tre profileve. Programi është hartuar për të plotësuar nevojën në tregun e punës në përputhje edhe me nevojat e vendit si dhe mbështetur në eksperiencat ndërkombëtare.</p>
<p><b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënljore në fuqi. Kjo qartësohet nga informacionet e marra në IAL dhe gjatë diskutimeve, konsultimit me dokumentacionin përkatës. Hartimi i këtij programi është mbështetur në formimin e profesionit të ekspertit të Politikave të zhvillimit të territorit dhe në misionin dhe qëllimin e IAL, nëpërmjet ofrimit të programeve të ndryshme në nivelet akademike BSc-MSc dhe Master Profesional si dhe Doktorature. Kjo është edhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit gradual të këtij institucioni.</p>
<p><b>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënljore në fuqi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënljore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënljore në fuqi. Megjithëse Ligji 80/2015 parashikon përshtatje të programeve Master Profesional në programe me 60 ose 120 ECTS, ky program ka ruajtur organizimin me 90 ECTS dhe kohëzgjatje 2 vjet falë statusit si program i përbashkët me IHS/Erasmus në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e përbashkët e firmosur nga të dy institucionet. Në këtë kuptim programi rregullohet nga neni 80 i Ligjit 80/2015. Kjo konstatohet nëpërmjet konsultimit me dokumentacionin përkatës.</p>
<p><b>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Vetë ri-organizimet që ka pësuar programi ndër vite, tregojnë vëmendjen që institucioni i kushton përmirësimit të vazhdueshëm të programeve dhe mënyrës së si ato ofrohen duke synuar rezultate sa më të mira të mësimdhënies dhe formimit të studentëve.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni dhe takimet gjatë vizitës në institucion:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. GVJ gjykon se programi është hartuar në përputhje me misionin e institucionit dhe strategjinë e tij të zhvillimit (aktualisht në fuqi strategjia 2014-2020).</li> <li>2. Programi i studimit merr në konsideratë nevojat e tregut të punës, zhvillimin ekonomik të vendit dhe vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</li> <li>3. Programi është i organizuar konform kuadrit ligjor në fuqi.</li> </ol>	

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Nga takimi me drejtuesit, u konstatua se pas hyrjes në fuqi të ligjit 80/15 dhe miratimit nga ministria e arsimit të statutit në fuqi të Universitetit POLIS, tashmë njësia përgjegjëse për organizimin e programit është Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban. (Më herët të gjithë programet organizoheshin në nivel Fakulteti).

Ky departament është një nga 3 njësitë bazë të Fakultetit të Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban dhe përbëhet nga staf akademik efektiv dhe me kontratë. Departamenti përmban staf vendas dhe të huaj.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban (FPMMU) ka në përbërje të tij 2 (dy) departamente përkatësisht: Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban dhe Departamenti i Mjedisit si dhe 1(një) Qendër Kërkimore: Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë.

Fakulteti plotëson stadardet e cilësisë sa i përket njërive bazë përberëse, numrit të stafit efektiv për çdo njësi bazë si dhe kualifikimin e tyre. (Tabela 1 e Aneksëve)

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti Planifikim dhe Menaxhim është i përbërë nga 9 (nëntë) anëtarë si staf akademik efektiv (PAE) dhe 18 (njëmbëdhjetë) anëtarë si staf akademik me kontratë (PAK) kurse sa i përket kualifikimit nga 9 Personel Akademik Efektiv, 5 staf kanë Tituj/Grada; dhe nga 18 staf Personel Akademik me Kontratë, 11 janë staf me Tituj/Grada. (Tabelat 1, 2, 3 të Aneksëve)

Në këtë kuptim departamenti plotëson standardet sa i përket numrit dhe kualifikimit të stafit.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:

(i) Statuti i Universitetit POLIS;

(ii) Organigrama e Stafit.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij; <b>Kriteri 2</b> Institucioni ka së paku dy Fakultete; <b>Kriteri 3</b> Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente; <b>Kriteri 4</b> Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar; <b>Kriteri 5</b> Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".	Mbështetur në dokumentacionin e RVB si dhe dokumentacioneve përkatëse të vëzhguara gjatë vizitës në IAL, U_POLIS në përbërjen të tij ka 3 fakultete të cilat plotësojnë numrin e njërive kryesore që duhet të përfshijë një IAL. Përkatësisht emërtimet e tyre janë si më poshtë vijon: 1-Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit • Departamenti Art dhe Dizajn • Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri • Qendra Kërkimore në Arkitekturë, Inxhinieri dhe Dizajn 2-Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban • Departamenti i Planifikimit dhe Mjedisit • Departamenti i Menaxhimit Urban • Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë 3-Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim • Qendra e Kërkimit Shkencor • Qendra e Kërkimit të Aplikuar • Qendra e Burimeve dhe Informacionit



	<p>Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban është i organizuar në dy departamente dhe një qendër kërkimore.</p> <p>Departamentet janë përgjegjëse për organizimin e programeve të studimit ndërkohë që qendra kërkimore është tërësisht e dedikuar për aktivitetet kërkimor shkencor.</p> <p>Gjithsesi stafi i të tre njësive bazë angazhohet si në mësimdhënie ashtu dhe në kërkim por në raporte të ndryshme sa i përket kohës që i dedikojnë secilës. Kjo koordinohet në nivel Fakulteti.</p> <p>Fakulteti plotëson standardet e cilësisë sa i përket njësive bazë përberëse, numrit të stafit efektiv për çdo njësi bazë si dhe kualifikimin e tyre.</p>
<p><b>Standardi II.3 - Njësiti e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësiti bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësiti bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban është përgjegjës për hartimin e programit të Master Profesional “Politikat e zhvillimit të territorit” më tre profile. Pjesë aktive në realizimin e PS janë edhe departamentet dhe njësia e kërkimit QËNDRUESHMËRIA, çfarë realizohet përmes propozimeve, sugjerimeve dhe bashkërendimit në nivele të ndryshme.</p> <p>Kriteret e rekrutimit të stafit akademik janë të përcaktuara në rregulloren institucionale të IAL mbështetur edhe në kontratat e përcaktuara nga Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Rekrutimi i stafit fillon me shpalljen e vakancës për vendin vakant nga departamenti, i cili përcakton dhe kriteret që kandidatët duhet të plotësojnë. Kandidatët intervistohen nga një komision ku njësia bazë dhe departamenti janë të përfaqësuar.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p>	
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Institucioni U-Polis është organizuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe në mënyrë të tillë që të përmbushë misionin e tij.</li> <li>2. Institucioni, Njësia Kryesore dhe Njësia bazë përgjegjëse për këtë program, plotësojnë të gjitha standardet cilësore dhe treguesit sasiore sipas kriterëve të përcaktuara e të paraqitura si më sipër.</li> <li>3. Rekrutimi i personelit akademik dhe vlerësimi i tij bëhet sipas dispozitave ligjore e akteve nënligjore me pjesëmarrjen e departamentit dhe fakultetit. GVJ kosultoi dokumentacionin e krijuar për rekrutimin e personelit nëpërmjet zgjedhjes rastësore dhe e gjeti atë të plotë, të sistemuar dhe konform kriterëve ligjore.</li> </ol>	

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Nga të dhënat statistikore për stafin akademik dhe CV-të e tyre, GVJ gjykon se stafi i angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Politika të Zhvillimit të Territorit”, me profile: “Planifikim hapësinor dhe aplikime GIS”, “Strehim dhe Zhvillim Toke”, “Zhvillim social urban dhe burime njerëzore”, ka kualifikimin dhe përvojën e duhur për të garantuar një mësimdhënie cilësore dhe për të transmetuar tek studentët njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për tregun e punës.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabela 6 e Anekseve)

Aktualisht, personeli akademik në këtë program studimi, është i përbërë nga 19 staf akademik me kohë të plotë dhe 6 staf me kohë të pjesshme, për një raport PAE/PAK 75% me 25%\* (shih tabelën 6 në anekse). Në Departamentin e Planifikimit dhe Menaxhimit Urban në të cilin zhvillohet edhe programi Master Profesional "Politikat e zhvillimit të territorit", ngarkesa e personelit akademik është në përputhje të plotë me parashikimet nënligjore për aktivitetet dhe standardet mësimore të personelit akademik në IAL, në varësi nga niveli i kualifikimit.

\*Në RVB POLIS e ka konsideruar stafin e IHS/Erasmus si staf PAE për këtë program studimi. GVJ ka ndjekur të njëjtën mënyrë llogaritje pasi IHS/Erasmus është institucion bashkëofrues i programit.

Për 6 vitet e fundit, raportet mes stafit PAE dhe atij PAK janë si vijon:

Viti akademik 2013 – 2014: PAE/PAK = 18 / 7 = 72% / 28%

Viti akademik 2014 – 2015: PAE/PAK = 17 / 5 = 77% / 23%

Viti akademik 2015 – 2016: PAE/PAK = 21 / 3 = 88% / 12%

Viti akademik 2016 – 2017: PAE/PAK = 20 / 4 = 83% / 17%

Viti akademik 2017 – 2018: PAE/PAK = 20 / 6 = 77% / 23%

Viti akademik 2018 – 2019: PAE/PAK = 15 / 5 = 75% / 25%

Nga analizimi i të dhënave për 6 vitet e fundit, evidentohet se përqindja e Personelit Akademik Efektiv është mbi 70% e totalit, duke përmbushur kështu standardin e kërkuar.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Personeli akademik dhe drejtuesit akademikë kryejnë veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor ose të aplikuar, shërbime për zhvillimin dhe sigurimin e cilësisë në U\_POLIS, këshillim për studentët, dhënie e ndihmës për studentët (këshillim akademik-tutorial) si dhe detyrat administrative në funksion të mësimdhënies. Në Departamentin e Planifikimit dhe Menaxhimit Urban në të cilin zhvillohet edhe programi Master Profesional "Politikat e zhvillimit të territorit", ngarkesa e personelit akademik është në përputhje të plotë me parashikimet nënligjore për aktivitetet dhe standartet mësimore të personelit akademik në IAL, në varësi nga niveli i kualifikimit (shih tabelën 7 në anekse).

- Të dhëna sipas moshës së personelit

Nga tabela 8 në anekse, vihet re që në shpërndarjen moshore stafi i angazhuar në programin e studimit Master Profesional "Politikat e zhvillimit të territorit", drejtuesit e lëndëve janë kryesisht në grupmoshat 36-65 vjeç, stafi i ri i grupmoshës 25-35 vjeç janë të angazhuar si asistent.

- Të dhënat sipas seksit

Raporti gjinor për stafin e angazhuar në këtë program studimi është 7/13 ose ndryshe 35 % me 65 %. Një arsye për këtë është fakti se në të shkuarën profesionet si arkitekt / urbanist ose inxhinier kanë qenë më të preferuara për meshkujt se sa për femrat. Sot ky trend ka ndryshuar dhe sugjerojmë që kjo të reflektohet dhe në një balanacë më të mirë gjinore në stafin mësimdhënës për këtë program. (Tabela 9 e Anekseve)

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Gjatë vizitës në U-Polis u informuam se për sa i përket procedurës së lidhjes së kontratës së punës, çdo anëtar i stafit administrativ dhe stafit akademik efektiv apo me kohë të pjesshme ndiqet një procedurë e cila nis me procesin e rekrutimit dhe përzgjedhjes, informimit të personit për përzgjedhjen e tij për t'u marrë në punë pranë U\_POLIS dhe më pas ai paraqitet dhe nënshkruan kontratën e punës e cila legalizon pozicionin e tij. Kontrata përfshin njohjen me detyrat dhe të drejtat e të dy palëve. Personit që rekrutohet i vihen në dispozicion të gjithë

dokumentet e brendshme, statute, rregulloret dhe udhëzimet në mënyrë që ai të njihet në detaje me të drejtat dhe detyrimet e punës në institucion. Ndërkohë, elementët thelbësor të të drejtave dhe detyrimeve përfshihen në kontratën individuale që personi nënshkruan pasi njihet me to.

Cilësia e stafit ndihmës/administrativ për çdo njësi bazë

Gjatë vizitës në Universitetin POLIS u informuam për cilësinë e stafit ndihmës/administrativ për çdo njësi bazë ku në kuadër të realizimit me sukses të procesit mësimor në tërësi dhe aspektit të formimit praktik në veçanti përmes laboratoreve, studiove, etj, personeli akademik me përvojë mbështetet nga stafi teknik si dhe laborantë. Sipas raportit dhe dokumentave të paraqitura, këta të fundit rekrutohen mbi baza kontratash me afat të caktuar sipas kërkesave dhe kohëzgjatjes së procesit akademik si dhe dinamikës së programeve dhe numrit të studentëve, ku më specifikisht brenda institucionit rezultoi se ka personel administrativ dedikuar laboratoreve në shërbim të programit të studimit, si laboratorit i prototipizimit dhe efikasitetit energjitike; CAD/GIS/MAC, dhe Laboratori i mjedisit. Gjithashtu në suport të stafit dhe studentëve është edhe zyra e IT e cila asiston në mënyrë të vazhdueshme të gjithë të interesuarit. Personeli ndihmës mësimor-shkencor është një hallkë shumë e rëndësishme e arritjes së standardeve të pritshme. Institucioni ka vënë në dispozicion të gjitha burimet njerëzore dhe infrastrukturore të nevojshme për të përmbushur të gjitha kërkesat e programit.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- (i) Procedura e rekrutimit të stafit
  - (ii) Kontrata me stafin akademik
  - (iii) Dosje e stafit akademik

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka angazhuar personel ndihmës për laboratore dhe mjediset shkollore. Persona të veçantë janë angazhuar për përkujdesjen ndaj laboratorëve. Gjithashtu laborantët ndihmojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e laboratorëve.</p>
<b>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Nisur nga vizita në institucion, bisedat me Dekanin dhe stafin akademik të Fakultetit të Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban rezultoi se personeli akademik është pjesë aktive në përmirësimin e kurrikulës, e cila ndikon në përmirësimet që lidhen me aspektet përmbajtëse të lëndëve.</p> <p>Propozimet për përmirësime kur impaktojnë ndryshime në kurrikulë bëhen në Këshillin e Fakultetit dhe miratohen në Senatin Akademik.</p> <p>Kriteret e rekrutimit të stafit akademik janë të përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme institucionale të IAL mbështetur edhe në kontratat e përcaktuara nga Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë.</p>
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Nisur nga vizita në IAL dhe verifikimin e dokumentacioneve dhe nga diskutimet përkatëse rezultojnë se në statutin, Rregulloren e Përgjithshme të IAL janë përcaktuar parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme gjë që respektohet edhe në procedurat reale të rekrutimit të stafit.</p> <p>Aktualisht, personeli akademik në këtë program studimi, është i përbërë nga 15 anëtarë staf akademik me kohë të plotë dhe 5 anëtarë staf me kohë të pjesshme, ku rezultojnë në raportin prej PAE/PAK 75% me 25%. Nga analizimi i të dhënave për 6 vitet e fundit, evidentohet se përqindja e Personelit Akademik Efektiv sipas planit mësimor të këtij programi është mbi 70% e totalit.</p> <p>Nisur nga shqyrtimi i Statutit, Rregulloren e Përgjithshme si edhe në Rregulloren e NJBSC-së, si dhe nga vizita në IAL dhe Verifikimi i dokumentacioni, bisedat me stafin dhe me studentët rezultojnë që periodikisht kryhet një vlerësim i performancës së personelit akademik.</p> <p>Vlerësimi i pedagogëve bëhet nga NJSBC përmes një metode që merr në konsideratë vlerësimin e studentëve, vlerësimin e kolegëve si dhe vetvlerësimin. Kjo procedurë realizohet përmes në pyetësori në sistemin kompjuterik dhe është transparente.</p> <p>Gjithashtu, rezultojnë se institucioni disponon të gjithë të dhënat mbi rekrutimin e personelit dhe shpall online në eëbsite-in e IAL njoftimet për vendet vakante.</p>
<p><b>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Përgjegjësi i programit është Përgjegjësi i Departamentit të Planifikimit dhe Menaxhimit Urban Dr. G.R, e cila është aktualisht në proces të marrjes së titullit Profesor i Asociuar.</p> <p>Në nivelin master të gjithë titullarët e lëndëve kanë grada shkencore ose janë në proces përfundimi të tyre dhe të gjithë kanë përvojë të gjatë në mësimdhënie.</p> <p>Institucioni ofron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të ndryshme publike, firma, studio apo institute private për angazhimin e studentëve në praktikat profesionale nëpërmjet Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës.</p>
<p><b>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në</p>	<p>Me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 80/2015 për Arsimin e lartë programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” përmbillen me provim përfundimtar</p>

<p>përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>formimi ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master profesional” në fushën e arsimimit të kryer.</p> <p>Sipas rregullores së programit Master Profesional “Politikat e zhvillimit të territorit” nga viti 2015 diploma “Master Profesional” fitohet kur rezultoni kalues në provimin final të diplomës.</p> <p>Në rastin e programit në fjalë, pothuajse të gjithë studentët kanë zgjedhur të diplomohen përmes provimit final që konceptohet me këtë përmbajtje: 40% (dyzet për qind) e vlerësimit i takon pyetjeve të specialitetit, dhe 60% (gjashtëdhjetë për qind) pyetjeve nga tematikat e tjera të zhvilluara gjatë programit master profesional. Në hartimin e tezës së provimit, që bëhet nga një komision i ngritur nga Dekani, përfshihen pedagogët e lëndëve që do të jenë pjesë e provimit final sipas përqindjeve të përcaktuara më sipër.</p>
<p><b>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 80/2015 për Arsimin e lartë programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” përmyllen me provim përfundimtar formimi ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master profesional” në fushën e arsimimit të kryer.</p> <p>Ndërkohë nga vizita e kryer në institucion me drejtuesit e programit u informuam se për ata studentë të cilët kanë kryer ciklin e studimit para hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 80/2015, për përgatitjen e tezës së diplomës procedura konsistonte: 1) në bazë të mesatares mbi 8 (tetë) në programin master profesional i/e cili kërkon të bëj temë studimi, në varësi të fushës së tij të interesit i miratuar nga udhëheqësi pjesë e stafit akademik.</p> <p>Miratimi i temës kryhej duke marrë parasysh jo vetëm përputhjen me programin e studimit por edhe midis temës studimore dhe fushës së specialitetit të ngushtë të udhëheqësit (lehtësisht verifikuar nga CV-ja e drejtuesve dhe fusha e udhëheqjes).</p>
<p><b>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga vizita në labororet e IAL dhe kontrollet mbi stafin akademik dhe administrativ u vu re që institucioni ka angazhuar personel ndihmës për mirëpërdorimin e ambienteve laboratorike në mjediset universitare. Me plotësimin e një sërë laboratorësh të rinj, si laboratorit i eficiencës së energjisë, laboratorit i Mjedisit, CAD dhe GIS etj, IAL ka angazhuar personel të veçantë që merret me përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e laboratorëve.</p> <p>Për më tepër, muajt e fundit me vënie në funksion të Laboratorit të mjedisit, është angazhuar edhe staf laborant që bashkëpunon me pedagogët e lëndës në rastet kur kërkohet përdorimi i instrumentave laboratorik.</p>
<p><b>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p>	

**Kriteri 1** Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

**Kriteri 2** Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.

Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre. Kjo shihet nga përputhja mes kualifikimeve të tyre dhe programeve ku ata janë të angazhuar.

Personeli akademik/mbështetës ndërton marrëdhënien e punësimit me institucionin në bazë të kontratës së punësimit. Të drejtat dhe detyrat e personelit akademik, ngarkesa dhe format e saj përcaktohen në Kontratën e lidhur mes tij dhe U\_POLIS. Kontratat janë në përputhshmëri me kuadrin ligjor në fuqi dhe rregullativ të institucionit.

### **Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.**

**Kriteri 1** Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

**Kriteri 2** Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;

**Kriteri 3** Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

Nga vizita në IAL dhe verifikimet e dokumenteve të arkivuara rezulton se IAL disponon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të gjithë personelin akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies pranë Zyrës të Burimeve Njerëzore në institucion.

IAL disponon një listë të plotë të stafit akademik të të gjithë institucionit, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ për cdo vit akademik.

Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik mbështetur kryesisht mbi Rregulloren e Përgjithshme të Institucionit.

Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore na u spjegua në mënyrë të detajuar procesi i rekrutimit, si dhe formularët për vlerësimin e aplikantëve. Në mënyrë rastësore u përzgjedhën dosje të stafit të ri të rekrutuar dhe u konstatua se procesi ishte kryer në zbatim të parashikimeve në rregullore.

### **Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Personeli akademik dhe ai ndihmës mësimor është angazhuar në realizimin e objektivave të programit Master Profesional në "Politikat e zhvillimit të territorit" në tre profile duke patur parasysh Strategjinë e Zhvillimit të U\_POLIS si dhe Rregulloren e Programit.
2. Për përmirësimin dhe rishqyrtimin periodik e të vazhdueshëm të kurrikulave, personeli akademik, në përputhje me procedurat përkatëse, përpilon ndryshimet e nevojshme dhe i dërgon për miratim në Senatin Akademik. GVJ konstaton ekzistencën e dokumentacionit përkatës.
3. Gjithashtu programi i ka kushtuar një vëmendje të veçantë mënyrës së zgjedhjes së stafit dhe cilësisë së tij. Referuar Programit Mësimor, vihet re se stafi i angazhuar në mësimdhënie mban grada dhe tituj shkencorë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Gjatë vizitës në U-Polis, nëpërmjet diskutimit me personat përgjegjës e konsultimit të dokumentacionit përkatës, GVJ konstaton që institucioni ruan informacionin e nevojshëm për stafin akademik dhe administrativ pranë Zyrës të Burimeve Njerëzore.

### **4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

#### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Universiteti POLIS ofron një infrastrukturë të përshtatshme dhe bashkëkohore për realizimin e aktiviteteve të nevojshme për të gjitha disiplinat, duke ofruar mjedise të brendshme por dhe të jashtme të cilat mund të konsiderohen tepër cilësore dhe plotësojnë më së miri kushtet për studim dhe punë të pavarur të studentëve. GVJ vizitoi ambientet e universitetit si klasat, auditorët, laboratorët, sallat e studimit, bibliotekën por dhe hapësirat e tjera të përbashkëta të studentëve dhe konstaton që të gjitha ambientet mund të konsiderohen bashkëkohore dhe që plotësojnë më së miri nevojat e studentëve. Gjithashtu u konstatua se kishte hapësira të mjaftueshme për stafin akademik por dhe atë administrativ, të pajisur me teknologji bashkëkohore dhe funksionale për kryerjen e kërkimeve akademike, shkencore dhe të aplikuara.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Mjediset për Programin e studimit (Treguesit sasiorë të mjediseve për PS janë listuar në tabelën 10 të Aneksëve)

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>U_POLIS ka zhvilluar një marrëdhënie kreative partneriteti privat-privat, për të mundësuar realizimin e një infrastrukture mësimore afatgjatë. Kështu GVJ gjeti që Bordi Themelues i U_POLIS dhe firma “Kler. Shpk” kanë nënshkruar një marrëveshje ombrellë për zhvillimin e përbashkët të infrastrukturës, me konceptin e bashkëpunimit për 99 vjet, e detajuar kjo përmes një kontrate me të drejtë rinovimi çdo 10 vjet.</p> <p>GVJ konstaton që U_POLIS, edhe pse në një kontekst global dhe kombëtar të vështirë për shkak të krizës ekonomike, ka zbatuar me sukses një formulë tepër të avancuar që vjen nga përvojat e vendeve perëndimore, duke garantuar në përfundim një kampus universitar kompakt prej 1 hektar toke, me 2 objekte (1 prej të cilave rezervë dhe në dispozicion të nevojave të rritjes së institucionit) si dhe me lehtësira të tjera si hapësira puulike, terrene sportive, parkim, gjelbërim, etj.</p>

Universiteti është i lidhur mirë me qytetin me 4 linja transporti publik njëra prej të cilave ofrohet falas nga U\_POLIS dhe tjetra nga QTU.

### Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

**Kriteri 1** Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;

**Kriteri 2** Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

**Kriteri 3** Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

**Kriteri 4** Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;

**Kriteri 5** Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.

Biblioteka e U\_POLIS ka një fond aktual prej 10,000 titujsh në përputhje me programet që ofron.

Biblioteka ka një literaturë të mjaftueshme por dhe të shumëllojshme e cila u vjen në ndihmë studentëve që dëshirojnë të përdorin këto burime, për realizimin e projekteve, kërkimeve shkencore por dhe përgatitjen e tezave të PS.

Nga vizita në bibliotekë u konstatua se ndodheshin periodikë të ndryshëm të shkruar por dhe elektronikë të revistave me influencë shkencore per PS por jo vetëm.

Drejtuuesi i fakultetit por dhe Përgjegjësi i Departamentit përgjegjës për këtë program studimi ishin shumë të angazhuar për pasurimin e vazhdueshëm të bibliotekës. Kjo bëhej e mundur nëpërmjet:

- ✓ Buxhetit të Departamentit;
- ✓ Donacioneve nga partnere te ndryshem;
- ✓ Kontribute te projekteve EU (TEMPUS, Erasmus +) etj
- ✓ Publikime/përkthime nga vete stafi i U\_POLIS.

Biblioteka ishte në dispozicion të studentëve gjatë gjithë ditës, madje ofronte shërbim edhe ditëve të veçanta në fundjavë. Biblioteka ishte e pajisur me hapësirat e nevojshme për punë të pavarur.

### Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

**Kriteri 1** Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

**Kriteri 2** Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

**Kriteri 3** Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

**Kriteri 4** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

POLIS ka investuar dhe synon të investojë në sigurimin e kushteve optimale infrastrukturore si edhe në teknologjinë bashkëkohore për të mundësuar mësimdhënie të një cilësie të lartë për të inkurajuar eksperimentimin dhe arritje të punëve kërkimore.

U\_POLIS ka aktualisht këto laboratorë në shërbim të programit të studimit:

1. Laboratori i CAD/SAP/ETABS/TEKLA
2. Laboratori i GIS
3. Sust\_LAB
4. Laboratori i Mjedisit

Të gjithë këta laboratorë janë shumë të rëndësishëm për programin e studimit.

### Konkluzionet e vlerësimit:

1. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjatë vizitës në institucion konfirmoi qartësisht se infrastruktura e vënë në dispozicion për realizimin e programit MP në PZHT është në përputhje me standardet e vendit dhe të BE-së.
2. Universiteti POLIS u ofron studentëve një ambient komod dhe të përshtatshëm për ndjekjen e aktivitetit akademik por edhe atij social. Në dispozicion të studentëve ka auditorë, klasa, sallë konferencash, mjedise të përbashkëta ku studentët mund të punojnë por dhe ambiente sociale ku mund të kalojnë kohën e tyre.
3. Biblioteka e institucionit është e pasur në botime periodike, me libra e revista të dobishme për procesin mësimor, projektet e kërkimit shkencor dhe përgatitjen e tezave të diplomave. Krahas fondit në hardcopy në



- bibliotekë aksesohet edhe një fond shumë i pasur si librari elektronike.
4. GVJ vizitoi laboratorët e institucionit dhe vlerëson që ato janë të pajisur me gjithë aparaturat e nevojshme si për të realizuar konkretizimin e procesit mësimor ashtu edhe për të krijuar bazë të dhënash për punën e pavarur të studentëve dhe aktivitetin shkencor.

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Grupi i vlerësimit të jashtëm kontaktoi stafin akademik dhe konsultoi dokumente të shkruara për të verifikuar burimet e financimit dhe menaxhimit të tyre nga U\_POLIS. Dhe në përfundim rezultoi se U\_POLIS është financuar nga një sërë të ardhurash si: tarifat e studimit, donacione; projekte të përbashkëta me partnere, fonde publike dhe të tjera.

Informacioni financiar i paraqitur më poshtë prezanton burimet e financimit ose të hyrat e universitetit sipas kategorisë: fonde publike, donacione dhe grande, tarifat e shkollimit, të ardhura të tjera projekte të përbashkëta etj, në vlerë absolute dhe si % ndaj totalit të burimeve. Gjithashtu ai paraqet përdorimin e burimeve financiare ose shpenzimet e kryera nga institucioni gjatë periudhës sipas kategorisë: paga, shpenzime dhe investime duke treguar edhe burimin e financimit të tyre. Raporti financiar vazhdon me llogaritjen e koston për student dhe më tej me ndarjen e përdorimeve sipas veprimtarive kryesore të institucioneve akademike që janë shpenzime për veprimtarinë akademike, shpenzime për kërkim shkencor dhe shpenzime për veprimtarinë e administrimit. Ndarja sipas kategorive të veprimtarive është bërë bazuar në angazhimet reale të stafit dhe shpenzimeve në tërësi duke marrë në konsideratë edhe udhëzimin e MAS mbi veprimtaritë e personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë.

Gjatë 2 viteve të fundit Universiteti POLIS është financuar nga disa burime si: tarifat e studimit, donacione dhe grande, projekte të përbashkëta dhe të ardhura të tjera.

**Në të ardhurat nga donacione** dhe grante janë pasqyruar pjesa vjetore që i takon periudhës e granteve në kuadër të projekteve Erasmus+ në të cilën Universiteti POLIS është partner, grante për realizimin e eventit *Tirana Architecture Week 2016* etj.

**Në tarifat e shkollimit** përfshihen pagesat që bëjnë studentët gjatë vitit akademik përkatës për shërbimin arsimor.

**Në të ardhura nga projekte të përbashkëta** përfshihen përfitime direkte të Universitetit POLIS në kuadër të projekteve të përbashkëta me partnerë lokalë dhe ndërkombëtarë. Këto të ardhura nuk kanë hyrë në kontabilitetin dhe llogaritë e Universitetit dhe nuk janë administruar dhe taksuar në POLIS, por nga partnerët me të cilët është zhvilluar projekti. Vetëm se në këtë rast përfitues i këtyre aktiviteteve ka qenë Universiteti POLIS. Këto fonde janë përfshirë në raport për të paraqitur një pamje të plotë të aktivitetit të Universitetit.

**Të ardhura të tjera përfshijnë të ardhura** nga aktivitete dytësore si angazhime në hartimin e planeve dhe projekteve të zhvillimit të territorit, konsulenca dhe ekspertiza profesionale, nënqera, zhvillim kurse dhe trajnime, zhvillim eventesh nga vetë institucioni dhe për të tretë etj.

Nga një analizë e burimeve të financimit shihet se përgjatë viteve është rritur pesha e burimeve të tjera të financimit duke realizuar synimin për diversifikimin e këtyre burimeve. Kështu aktualisht të ardhurat nga këto burime kanë arritur në nivelin **23%** të totalit. Kjo situatë është reflektim i strategjisë financiare të universitetit për diversifikimin e burimeve të financimit, uljen e ekspozimit ndaj risqeve të financimit afatshkurtër me synim qëndrueshmërinë financiare.

Rezulton se U\_POLIS përdor burime financiare të diversifikuara dhe mbështetet më tepër në mjete të tjera financiare si grante për projekte të përbashkëta sesa në tarifat e studimit.

POLIS është ndër institucionet shqiptare që ka fituar rolin e partnerit lider në një program TEMPUS, duke mbajtur grandin prej 825,000 Euro, të siguruar nga Bashkimi Europian. Kjo tregon për besueshmërinë ndaj kapaciteteve të institucionit për menaxhimin e shumave të tilla. Ky projekt ka vijuar dhe me fitimin e shumë projekteve të tjera të Universitetit POLIS nga ku ka patur jo vetëm përfitime financiare por dhe shume mobilitete të stafit dhe studentëve.

Të dhëna të detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në tabelat 11 dhe 12 të Aneksëve.

## Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë; <b>Kriteri 2</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë; <b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	Nga vizita u konstatua se monitorimi i aktiviteteve financiare kryhet rregullisht nga Bordi i Administrimit si dhe Asambleja e Ortakëve.  GVJ konstatoi qe Zyra e financës çdo vit harton bilancin vjetor. Për këtë qëllim ishte kontraktuar një kompani konsulencë financiare, e cila asistonte Zyrën e Financave për probleme dhe aspekte financiare ndërkohë që një ekspert kontabël i autorizuar kontrollonte dhe verifikonte bilancin vjetor të hartuar nga Zyra e Financave.  GVJ u njoh me raportin financiar që hartohet në përfundim të këtij procesi.
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj. <b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.	Institucioni harton raporte vjetore financiare që përmbajnë të dhëna për aktivitetin financiar të tij.  Këto raporte janë përpiluar për të gjitha vitet akademike.  GVJ konstatoi që Institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare nga tarifat e studimit por edhe donacionet dhe bashkëpunimi me partner lokale dhe ndërkombëtarë.
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
<ol style="list-style-type: none"><li>1. Grupi i vlerësimit konstaton se Universiteti POLIS ka një auditim të përvitshëm (të jashtëm) të situatës financiare.</li><li>2. GVJ konstaton që raporti i auditit pasqyron ndër të tjera grantet e huaja dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të PS. Ai analizon edhe eficiencën e të ardhurave nga tarifat e studentëve.</li><li>3. Në shqyrtimin tërësor të situatës financiare GVJ konstaton që Institucioni ka qëndrueshmëri financiare për zhvillimin edhe të PS MP në PZHT dhe ka edhe kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</li></ol>	

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Në Raportin e vlerësimit të brendshëm grupi i vlerësimit shprehet:

*Në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit POLIS, institucioni ka ngritur një njësi të qëndrueshme, strukturimi, përgjegjësitë dhe funksionimi i së cilës përcaktohet qartë në "Rregulloren e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë" miratuar me vendim të Senatit Akademik. Rregullorja shpreh qartë rëndësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë nëpërmjet së cilës garantohet cilësia gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore,*

shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe organizative të Universitetit POLIS.

NJBSC është një njësi e përhershme e pavarur, e cila nëpërmjet punës së saj në vlerësimin e cilësisë, synon krijimin dhe konsolidimin e kulturës së cilësisë në Universitetin POLIS. Njësia përbëhet nga 9 anëtarë (Tabela 13 e Anekseve), një ndër të cilët është përfaqësues i Studentëve dhe një përfaqësues i Alumni. Është organ me karakter të përhershëm, këshillimor dhe vlerësues dhe ka autonomi operative dhe qasje në të gjitha të dhënat e institucionit.

Parimet mbi të cilat është ndërtuar NJBSC:

1. Krijimi i një tabloje të qartë dhe reale rreth gjendjes aktuale të universitetit;
2. Ngritja e një sistemi efikas për sigurimin dhe krijimin e kulturës të cilësisë në institucion;
3. Garantimi i transparencës me qëllim informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerë për performancën e POLIS, njësive, programeve, kurrikulave, shërbimeve etj.

Gjatë takimit me anëtarët e NJBSC u konstatua se kishte një ndarje të qartë të detyrave të anëtarëve të njësive. Kjo ndikonte drejtpërdrejt me kontrollimin dhe përmirësimin e cilësisë.

Këtu mund të përmendim se një nga anëtarët ishte i angazhuar vetëm për menaxhimin e procesit të vlerësimit të mësimdhënies, një tjetër për monitorimin e proceseve administrative. Po ashtu kishte përfaqësues dhe përgjegjës për kontrollimin e procesit kërkimor shkencor etj. Të gjitha këto konstatime të krijojnë një tablo të qartë dhe konkrete në fushën e cilësisë dhe përmirësimit të saj.

Objektivat e NJBSC janë:

- ✓ monitorimi i vazhdueshëm i institucionit;
- ✓ ndjekja e vazhdueshme e programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre;
- ✓ ndjekja e vazhdueshme e nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës, si edhe kualifikimit të tij; monitorimi i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe i vlerësimit të studentëve dhe ruajtja e cilësisë së tij;
- ✓ ndjekja e vazhdueshme e ecurisë së kërkimit shkencor në institucion; ndjekja e ecurisë së bashkëpunimit të U\_POLIS me institucione të tjera akademike, shkencore dhe jo akademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- ✓ monitorimi i nivelit të përfshirjes së studentëve në veprimtaritë e përditshme të institucionit.

Duhet theksuar se në fund të çdo viti akademik të dhënat e procesit të vlerësimit grumbullohen, përpunohen dhe mbi bazën e tyre hartohet Raporti Vjetor<sup>2</sup>, i cili i paraqitet në formë zyrtare Rektoratit për t'ju vënë në dispozicion Senatit Akademik. Bazuar në të dhënat e raportit nxirreshin rekomandimet përkatëse për përmirësimin e procesit të cilësisë dhe mësimdhënies dhe sigurohet që ato të zbatohen në çdo njësi të institucionit.

Dy vitet e fundit universiteti është duke u angazhuar në një projekt Erasmus+, Key Action 2, QainAL "Mbështetja strategjike për forcimin e strukturave të Sigurimit të Cilësisë në Institucionet Private të Arsimit të Lartë në Shqipëri", për më shumë (<http://www.qainal.eu/page.aspx?id=1,2>).

GVJ u informua që ky projekt ka për qëllim të krijojë dhe të mbështesë proceset për sigurimin e cilësisë dhe mekanizmat për të siguruar menaxhim efektiv, për të përmirësuar mësimdhënien dhe të nxënit në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri. Projekti synon të mbështesë institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri për të arritur prioritetet e dy dokumenteve kryesore: "Rritja e ndikimit të Zhvillimit të BE-së: një Agjendën për Ndryshim" dhe "Arsimin e Lartë European në Botë". Projekti synon përmirësimin e menaxhimit dhe funksionimit të institucioneve të arsimit të lartë.

Gjithashtu u konstatua se të gjitha programet e ofruar pranë U\_POLIS janë të akredituara, dhe vetë POLIS si institucion është akredituar dhe ri-akredituar dy herë.

Krahas këtyre vlerësimeve kombëtare POLIS, i është nënshkruar edhe procedurave të vlerësimit të cilësisë dhe të akreditimit sipas standardeve ndërkombëtare si vijon:

<sup>2</sup> Raportet Vjetore NJBSC, ndodhen të arkivuara në ambjentet e NJBSC.

1. Akreditim i përvitshëm nga autoritet përgjegjëse Italiane në kuadër të programit të përbashkët doktoraturë midis Universitetit POLIS dhe Universitetit Ferrara, duke filluar që nga viti akademik 2013-2014 dhe në vazhdim.
2. Përmbyshja e standardeve të cilësisë së Bashkimit Evropian dhe kërkesave të akreditimit në vendet e origjinës, IPAG Business School, Paris, Francë dhe IHS/ERASMUS University, Rotterdam, Netherlands në bashkëpunim me të cilat Universiteti POLIS ofron tre programe të studimi Master Profesional me nga tre profile secili.
3. Akreditim nga AESOP për programin e studimeve të integruara (5-vjeçare) Planifikim dhe Menaxhim Urban, data e lëshimit dhjetor 2015.

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët:

Nga metodologjia e përdorur studentët anketohen për çdo lëndë / modul në përfundim të lëndës si dhe njëherë në vit për cilësinë e shërbimeve nga njësitë administrative.

- Sa studentë janë anketuar:

Bazuar në takimin me NJSBC na u shpjegua se tashmë POLIS e ka përfshirë në kontratën e studentit detyrimin për të vlerësuar secilën lëndë / modul, pra synimi është anketimi i të gjithë studentëve, tashmë ata vlerësimin e kryejnë online dhe mund ta bëjnë në ambientet e shkollës ose jashtë saj.

- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë:

Të gjithë pyetësorët përpunohen dhe rezultatet e gjeneruara përfshihen në raportin e përvitshëm të NJSBC.

- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm:

Ky raport dërgohet në Departamente / Dekanate dhe Rektorat si dhe prezantohet para Senatit Akademik.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Një prej detyrave më të rëndësishme të NJSBC është dhe procesi i vlerësimit të cilësisë dhe performancës së stafit akademik në procesin mësimor. Prosesi i vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies të stafit akademik përbëhet nga 4 komponentë vlerësimi komplementarë: nga studentët, kolegët, vetvlerësimi (vetvetja) dhe nga eprori/ët. (Aneks 17, 17.1, 17.2, 17.3 të RVB; Formularët për çdo proces vlerësimi).

(1) Vlerësimi nga studentët (pesha në vlerësimin total është 50%):

Të dhënat e fituara nga këta pyetësorë, pas përpunimit shfrytëzohen gjerësisht në mbështetje të procesit, ku, gjatë të cilit drejtuesit e institucionit bëjnë vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të viti akademik. Përmbajtja e pyetësorëve është standarde dhe konsiston me një interval vlerësimi nga 1 (minimumi i vlerësimit) deri te 5 (maksimumi i vlerësimit). Plotësimi i pyetësorit është konfidencial dhe plotësohet në mënyrë elektronike.

(2) Vlerësimi nga kolegët (pesha në vlerësimin total është 35 %):

Proces i cili kryhet nëpërmjet ndjekjes së procesit mësimor nga kolegët. Për realizimin sa me korrekt dhe në kohë njësia ka hartuar një kalendar, nëpërmjet të cilit përcaktohen afatet kohore se kur duhet të përfundojë vlerësimi në fjalë.

(3) Vetë-vlerësimi (pesha në vlerësimin total është 15%):

Vetëvlerësimi i pedagogëve është gjykuar si një komponent që dëshmon për shkallën e njohjes që vetë pedagogët kanë për cilësinë dhe kulturën e cilësisë dhe shkallën e vetkritikës me synim përmirësimin e vazhdueshëm individual.

(4) Vlerësim nga drejtuesit:

Vlerësimi i katërt është vlerësimi që realizohet përmes një procesi analize dhe feedback të kombinuar edhe me analizat semestrale. Gjithashtu vlerësimi që kryhet nga drejtuesit përmes ballafaqimeve e bisedave informale e plotëson kuadrin e vlerësimit nga këndvështrimi i pritshmërive të drejtuesve dhe kërkesave që kanë për cilësinë e aktivitetit akademik. Me stafin e ri ky proces përfshin dhe fokusohet në këshillim, orientim, njohjen me praktikën më të mirë me synim përmirësimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e sensit vetkritik.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë në nivel departamenti, nga drejtuesit e NJBSC janë: monitorimi i vazhdueshëm i drejtimit të institucionit; ndjekja e vazhdueshme e programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre; ndjekja e vazhdueshme e nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës, si edhe kualifikimit të tij; monitorimi i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe i vlerësimit të studentëve dhe ruajtja e cilësisë së tij; ndjekja e vazhdueshme e ecurisë së kërkimit shkencor në institucion; ndjekja e ecurisë së bashkëpunimit të U\_POLIS me institucione të tjera akademike, shkencore dhe joakademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar; dhe monitorimi i nivelit të përfshirjes së studentëve në veprimtaritë e përditshme të institucionit.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Rregullore NJSBC
- Plan pune NJSBC
- Formularët e vlerësimit (4 lloje)
- Raport NJSBC
- Strategji të NJSBC

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</li> <li>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</li> <li>c. Pyetje konceptuale;</li> <li>d. Intervista;</li> <li>e. Etj.</li> </ol> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</li> <li>b. Dëgjime në auditor;</li> <li>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</li> <li>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</li> <li>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra</li> </ol>	<p>POLIS ka pjesë të strategjisë së tij përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësim-nxënies dhe, për këtë arsye, mbi baza vjetore bëhet vlerësimi i ecurisë së programeve, nëpërmjet shqyrtimit të anketimeve prej studentëve, mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët, sugjerimeve prej pedagogëve të përfshirë në këtë program studimi etj.</p> <p>Aktiviteti i monitorimit organizohet nga NJBSC, për secilin nga proceset akademike/administrative që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë rektoratit dhe dekanëve të fakulteteve.</p> <p>Nga këto kontrole janë hartuar raporte, janë prodhuar vlerësime, janë nxjerr rekomandime dhe janë lënë detyra për përmirësimin e procesit mësimor si dhe janë propozuar masa për ndryshime apo korrigjime për raste ose çështje konkrete.</p> <p>Për kryerjen e vlerësimit janë përdorur metoda të shumëllojshme të drejtpërdrejta ose të tërthorta. GVJ konsultoi sondazhet, pjesëmarrjen në mbrojtjen e tezave, ndjekjen e ecurisë së studenteve, punësimin, opinionin e studenteve, rezultatet e marra nga studimi i tregut të punës etj.</p> <p>Rezultatet e përfituara nga pyetësorët i bëheshin të ditura stafit, studentëve si dhe administratës.</p> <p>Të dhënat ishin pjesë e Raportit Vjetor që institucion dërgon në MASR dhe ASCAL.</p> <p>Nga GVJ iu kërkua Sekretarisë Mësimore</p>

- kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);
- f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;
- g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;
- h. Etj.

dokumentacioni lidhur me vlerësimin e studentëve, metodat që përdoren për kontrollin e mësimnxënies të cilat iu vunë në dispozicion.

CVJ u njoh konkretisht me procesverbalet e rezultateve të studentëve, mënyrën e vlerësimit të pedagogëve për studentët dhe konstatoi që dokumentacioni ishte i plotë dhe konform dispozitave ligjore.

Me kënaqësi u konstatua se rezultatet e studentëve ishin të kënaqshme.

**Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.**

**Kriteri 1** Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;

**Kriteri 2** Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.

U\_POLIS, përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë. Të dhënat e rezultateve bëhen pjesë e raporteve të Fjesshme dhe atyre vjetore të NJBSC nga njëra anë dhe Raportit Vjetor të Përgjithshëm që përgatitet në fund të çdo viti akademik, nga ana tjetër.

Ky raport i dërgohet MAS dhe ASCAL, ndërkohë që rezultatet janë lehtësisht të qasshme në bibliotekën e U\_POLIS si nga studentët ashtu dhe stafi akademik.

POLIS organizon pyetësor të brendshëm mbi cilësinë e programeve, të personelit akademik, dhe cilësinë e mësimdhënies dhe po planifikon ta publikojë në të dhënat kryesore në faqen e internetit të U\_POLIS

**Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.**

**Kriteri 1** Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;

**Kriteri 2** Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Programet vlerësohen pas çdo semestri dhe në fund të çdo viti akademik bëhet një analizë vjetore. Ky proces është nën përgjegjësinë e NJBSC në bashkëpunim me koordinatorin e procesit mësimor. Procesi i vlerësimit deri më sot mbështetet në vlerësimin nga studentët, nga kolegët, nga eprorët dhe vetëvlerësimi. Gjetjet kryesore të raportit vjetor bëhen publike dhe diskutohen në një mbledhje të hapur të Senatit Akademik me pjesëmarrje të lirë të stafit.

Si përgjigje, *feedback* ndaj mangësive, problemeve apo sugjerimeve, drejtuesit kanë marrë masa konkrete që lidhen me procesin mësimor, strukturën didaktike apo cilësinë e korrektësinë e mësimdhënësve të veçantë.

Këto rezultatet u bëhen të njohura stafit dhe studentëve.

**Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.**

**Kriteri 1** Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

**Kriteri 3** Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe

U\_POLIS i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm dhe ka fituar akreditimin periodik institucional për të tretën herë në vitin 2017 realizuar nga ASCAL dhe QAA.

Ky proces është realizuar pavarësisht një akreditimi në fuqi, atij të fituar përmes Urdhrit Nr. 267, datë 20.05.2016 "Për Akreditimin

standardeve të programeve të tyre;

**Kriteri 4** Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;

**Kriteri 5** Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

**Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Institucional të Universitetit "POLIS".

Kjo dëshmon qartë dëshirën e madhe të institucionit për përmirësimin e cilësisë së ofruar.

Të gjitha politikat që vihen në shërbim për të siguruar cilësinë e proceseve akademike hartohen përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre në organet kolegjiale si Senati Akademik, Rektorat etj.

GVJ konstatoi që edhe për PS MP në PZHT institucioni ka përdorur mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin si dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të ofruara si grupet e punës për probleme të veçanta, organet e përhershme kolegjiale brenda fakulteteve si dhe këshillimi me specialistë të fushës brenda ose jashtë institucionit.

Duke ditur që ndërgjegjësimi i personelit për sigurimin e cilësisë për programet e ofruara në universitet lidhet drejtpërdrejt me vizionin që ka institucioni për të ofruar programe të një cilësie sa më të mirë, procedurat e punësimit të një anëtarë të ri në stafin akademik lidhet dhe me njohjen e tij me vlerat, misionin dhe vizionin e institucionit. Në kontratën e punësimit, veç të tjerave kërkohej që personeli të bëhej pjesë e filozofisë së U\_POLIS për të rritur cilësinë dhe për ta siguruar atë si vlerë sociale e kulturore.

### Konkluzionet e vlerësimit:

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, takimin me anëtarët e NJBSC, stafin akademik si dhe në takimin me studentët u arrit në përfundimin se:

1. NJBSC (Njësia e Brendshme për Sigurimin e Cilësisë) në POLIS ka një status institucional të mirëpërcaktuar si njësi permanente e mbështetur në anëtarë të brendshëm por dhe me përfaqësues nga studentët dhe nga ALUMNI.
2. GVJ konstaton që NJBSC prodhon dokumentacion të besueshëm dhe efikas për përmirësimin e cilësisë edhe për PS MP në PZHT.
3. Kjo njësi ka një rregullore mbi të cilën bazon aktivitetin e saj si një njësi me autonomi dhe përgjegjësi maksimale për të kryer aktivitetin e kontrollit, evidentuar problematikat dhe sugjeruar përmirësimet e nevojshme të cilat lidhen drejtpërdrejt me cilësinë.
4. GVJ konkludon që NJBSC është plotësisht e angazhuar të monitorojë dhe raportojë në mënyrë të vazhdueshme rreth cilësisë së brendshme të institucionit.
5. Institucioni garanton sigurimin e cilësisë për programet që ofron. Për të realizuar këtë proces ka një metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese.
6. Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior dhe cilësor për vlerësimin e brendshëm. E gjithë veprimtaria e institucionit në lidhje me cilësinë përputhet me vizionin dhe udhëhiqet nga objektivat e strategjisë.

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### 7. Programi i studimit, organizimi i tij

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij

(lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Në lidhje me programin e studimit Master Profesional në "Politikat e Zhvillimit të Territorit", institucioni ka të mirë përcaktuara misionin dhe objektivat e programit të studimit, në rregulloren e programit të studimit. Gjithashtu në dokumentacionin e paraqitur nga Departamenti përgjegjës, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies) paraqiten dhe plotësojnë kriteret e duhura. Lëndët pjesë e këtij programi disponojnë silabuset përkatëse ku parashtrihen qartë elementët përbërës të tyre.

Gjatë takimit me drejtuesit e departamentit u diskutua për përshtatjen e elementëve të syllabusit me udhëzimin e vitit 2018 të MASR për këtë qëllim.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

✓ Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi ka filluar aktivitetin në vitin akademik 2011-2012 me 28 studentë në total për të 3 profilet, dhe qëllimet dhe objektivat e programit të studimit janë artikuluar qartë në rregulloren e programit të studimit.

✓ Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Ky program është i organizuar në formën e studimeve me kohë të pjesshme, me kohëzgjatje 2 vite akademike, dhe 90 ECTS në total.

- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore = 60' minuta

✓ Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Tabela 17 e Aneksëve)

Programi i studimit Master Profesional në "Politikat e zhvillimit të territorit", 2 vjeçar përmban 11 lëndë të organizuara në 11 module bazë me një total prej 75 ECTS të cilët përfshijnë internshipin profesional si edhe temën dhe provimin/temën e diplomës dhe 3-5 module me zgjedhje me një total 15 ECTS. Studentët përmbushin kërkesat për titullin Master Profesional në Politikat e zhvillimit të territorit nëse plotësojnë 90 kredite sipas sistemit ECTS. Kreditet janë të llogaritura sipas sistemit ECTS. Një krediti të formimit i korrespondon 25 orë mësimore punë të studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, etj.) dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të tij.

GVJ e gjen kurrikulën të organizuar në përputhje me objektivat e programit dhe si përmbajtje (lëndët dhe modulet) por dhe pesha specifike që secila lëndë zë në formimin e përgjithshëm që i ofrohet studentit.

Ndarja sipas veprimtarive formuese pasqyrohet në Tabelat 14 dhe 15 të Aneksëve.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 8 - 12 orë në auditor dhe 13-17 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 6 - 18 orë në auditor dhe 17-19 orë punë e pavarur e studentit
- Për Labororet 12 - 18 orë në auditor dhe 7-13 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 20 - 25 orë në auditor dhe 0-5 orë punë e pavarur e studentit

GVJ e gjen këtë ndarje të përshtatshme për natyrën dhe nivelin e programit të studimit si dhe në përputhje me udhëzimet për këtë qëllim.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Tabela 16 e Aneksëve)



Programet e studimit janë subjekt rishikimi dhe përmirësimi të vazhdueshëm, bazuar në sugjerimet nga studentët, ALUMNI, partnerët lokalë dhe ndërkombëtarë, komuniteti i biznesit, studimet e tregut, ekspertët e jashtëm gjatë vlerësimit të cilësisë, etj.

Nga verifikimi i planeve mësimore, u konstatua që programi kishte pësuar pak ndryshime krahasimisht me akreditimin fillestar, që konsistonte kryesisht në grupim të tre moduleve të ndryshme në një lëndë të vetme të organizuar në formë studio / laborator, me fokus më specifik lidhur me secilin nga 3 profilet.

Masa e ndryshimit është rreth 16%, megjithëse më shumë se sa ndryshim lëndësh, ky mund të konsiderohet përmirësim i organizimit të formës së mësimdhënies dhe harmozim i njohurive që më parë ofroheshin në mënyrë më të fragmentuar, kurse tani jepen në formë të integruar. Detajet për modulet e ndryshuara jepen në tabelën 16 e Aneksëve.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Nga të dhënat e paraqitura në planin mësimor (Tabela 17 e Aneksëve) në lidhje me stafin e angazhuar në programin e studimit, ai përbëhet nga 15 pedagogë Personel Akademik Efektiv (me kohë të plotë) dhe 5 pedagogë Personel Akademik me Kontratë (staf me kohë të pjesshme), nga të cilët për Personelin Akademik Efektive 2 me titull Prof., 7 me gradën shkencore Doktor, 5 kandidatë në doktoraturë dhe 1 me gradë shkencore MSc. Personeli Akademik me Kontratë përbëhet nga 3 lektorë me gradën shkencore Doktor dhe 2 në proces doktorature. Raporti staf efektiv / staf me kontratë është 75 % /25%.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve:

Syllabuset e depozituara si pjesë e DVV janë të gjitha të hartuar sipas të njëjtit format, i cili përmban të gjithë elementët e mësipërm.

Në përmbajtjen e tyre, syllabuset përcaktojnë qartë objektivat formues, të cilët janë në përputhje me objektivat e përgjithshëm të programit të studimit dhe nga analizimi i tyre dhe metodologjive të mësimdhënies vërehet fokusi tek thellimi teorik i studentëve por dhe aftësimi i tyre praktik. Të gjitha modulet trajtojnë tema bashkëkohore dhe relevante për formimin e studentëve. Metodologjitë e mësimdhënies janë gjithashtu të larmishme dhe në përputhje me objektivat e lëndës.

Gjatë vizitës në institucion, u konfirmua nëpërmjet takimit me stafin dhe studentët së syllabuset hartohen nga titullarët e lëndëve dhe më pas miratohen në departament e fakultet. Studentët njihen me syllabuset e lëndëve që në fillim të semestrit dhe mund ti konsultojnë ato në çdo kohë pasi janë të aksesueshme online në portalin e studentit në sistemin elektronik.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- (i) Rregullore didaktike
  - (ii) Rregullore e programit të studimit
  - (iii) Syllabuset e lëndëve

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi Master Profesional në “Politikat e zhvillimit të territorit” është në përputhje dhe në zbatim të strategjisë, misionit dhe qëllimit të IAL. Ai ofron program mbështetur në ECTS me 90 kredite në dy vite, duke ruajtur një balancë të krediteve dhe ngarkesës mësimore ndër vite.</p>
<p><b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi Master Profesional në “Politikat e zhvillimit të territorit” është në përputhje dhe në zbatim të strategjisë, misionit dhe qëllimit të IAL -Polis.</p> <p>Ky program studimi është në përputhje të plotë me kriteret e vendosura, pasi ofron njohuri të thelluara praktike analitike dhe profesionale në politikat e territorit. Në hartimin e programit mësimor është mbajtur parasysh raporti midis formave të ndryshme të veprimtarive formuese. Kështu rreth 50 % e tyre janë në disiplina karakterizuese që lidhen me fushën, si dhe veprimtari formuese plotësuese si praktika apo stazhe, që e gjejnë një ndarje shumë të përshtatshme për aftësimin e studentëve për nevojat e tregut të punës dhe në përputhje me fokusin profesional të këtij programi master.</p>
<p><b>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit, lëndët e ofruara janë në përputhje me kërkesat e një programi profesional të ciklit të dytë.</p> <p>Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe diskutimet me pedagogët dhe studentët rezultoi që studentët vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme duke përdorur disa metoda vlerësimi të cilat përipiqen të përfshijnë të gjithë gamën e njohurive që studenti përvetëson si ese, detyra, teste, dorëzime të ndërmjetme.</p>
<p><b>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensionet ndërkombëtare.</b></p>	

<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimeve në Master Profesional në “Politika të Zhvillimit të Territorit” falë dhe statusit si program i përbashkët me IHS/Erasmus është një program konkurrues në nivel evropian dhe janë hartuar mbështetur në përvojën e mirë të institucionit partner. Programi është në përputhje edhe me kriteret me proceset e kartës së Bolonjës.</p>
<p><b>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Për vetë natyrën profesionale të këtij programi master, fokusi parësor është aftësimi profesional i studentëve i cili realizohet përmes praktikave të shumta lëndore, orëve me natyrë aplikative si studio ose laborator, etj. Gjatë diskutimit me studentët e viteve të ndryshme pjesëmarrës në këtë program u vu re që një pjesë e tyre përveç praktikave mësimore janë angazhuar vazhdimisht në kërkimet shkencore dhe projektet e bashkëpunimit të U-Polis.</p> <p>Programi i studimit është në përputhje me strategjinë dhe perspektivën e zhvillimit të IAL dhe projekteve të miratuara për kërkimin shkencor.</p> <p>Personeli inkurajohet të angazhohet në punë kërkimore sidomos në ato projekte të cilat kanë një impakt direkt në zhvillimin e vendit dhe që lidhen drejtpërdrejt apo indirekt edhe me realizimin e programit studimor akademik.</p>
<p><b>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Politikat e zhvillimit të territorit” me tre profile është mbështetur mbi planin strategjik të IAL.</p> <p>Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe diskutimeve të hapura në U-Polis, si dhe nga informacionet e dhëna për punësimet në tregun e punës u vu re se ky program është përshtatur me nevojat e tregut të punës si dhe studentët që kanë ndjekur studimet në këtë program janë të punësuar në tregun e punës.</p>
<p><b>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;</li> <li>b. kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>d. numrin e të regjistruarve në programe të</li> </ol>	<p>Programi i studimit MP në PZHT është mbështetur mbi planin strategjik të IAL.</p> <p>Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe diskutimet e hapura në U-Polis, si dhe nga informacionet e dhëna për punësimet në tregun e punës, u vu re se ky program është përshtatur me nevojat e tregut të punës si dhe studentët që kanë ndjekur studimet në këtë program janë të punësuar në tregun e punës.</p>

ngjashme në institucionet simotra.	
<b>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare; <b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.	Institucioni ofron programe që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Përkundrazi fokusimi i tij në çështje me rëndësi të lartë kombëtare si planifikimi i territorit dhe statusi i M.Prof në PZHT si program i përbashkët me një institucion prestigjioz ndërkombëtar ndihmojnë në rritjen e cilësisë së arsimit të lartë në vend dhe ndërtimin e ekspertizës në fushën e zhvillimit të territorit.
<b>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.</b>	
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.	GVJ konstaton që PS MP në PZHT në Universitetin POLIS realizohet me 90 ECTS me kohëzgjatje 2 vite akademike, kjo në përputhje me aktet ligjore për hapjen dhe ri-organizimin e tij.
<b>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët; <b>Kriteri 2</b> Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	Programi i studimit, me lëndët përbërëse të tij, sipas viteve dhe semestrave është i publikuar në faqen e internetit të IAL. Nga vizitat në IAL dhe bisedat me studentët u vrojtua se ata kanë akses përmes sistemit elektronik në të gjithë syllabuset e lëndëve, të cilat përfshijnë: temat e lëndës, literaturën kryesore, format e kontrollit të dijeve, literaturën e rekomanduar, etj.
<b>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar; <b>Kriteri 2</b> Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	Diploma përmbyllet përmes një provimi final dhe nënshkruhet nga Kryetari i Komisionit të provimeve të formimit dhe Dekani i Fakultetit përkatës dhe rektori i Universitetit "POLIS". Për secilin prej tyre shënohet emri, mbiemri, grada dhe titulli shkencor. Nënshkrimet e tyre vërtetohen me vulën e "POLIS", dhe kanë kode sigurie.
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
Bazuar në dokumentacionin e konsultuar dhe takimet me drejtuesit, stafin dhe studentët gjatë vizitës në Institucion, GVJ gjykon se:	
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Programi i Studimit MP në PZHT me tre profile është hartuar në përputhje me misionin, vizionin dhe strategjinë për zhvillim të institucionit.</li> <li>2. Programi është i akredituar. Plani mësimor i tij është i organizuar në module dhe çdo modul është i vlerësuar me ECTS.</li> <li>3. Programi MP në PZHT zhvillohet në 2 vite akademike.</li> <li>4. Programi adreson nevojat e tregut të punës, të cilat janë identifikuar nga IAL nëpërmjet një studimi tregu.</li> <li>5. Objektivat e programit dhe përmbajtja e kurrikulës janë të përshtatshme për nivelin e studimit dhe mundësojnë aftësimin profesional dhe shkencor të studentëve.</li> <li>6. Ky program mbështetet në përvojën disavjecare të aplikimit të tij dhe ka arritur një dimension të lartë ndërkombëtar falë statusit si program i përbashkët me IHS/Erasmus University of Rotterdam.</li> </ol>	

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Organizimi i mësimdhënies bëhet përmes orëve të leksionit, seminareve, orëve studio, praktikave mësimore dhe pune laboratorike. Me pajisjen e Universitetit me Laboratorë një pjesë e orëve të praktikës zhvillohen edhe si punë laboratorike që për shkak të profilit të studimeve konsiderohen dhe si orë pune në studio.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

Bazuar në tabelën 18 të Aneksve konstatohet që peshën më të madhe të orëve e zënë aktivitetet që synojnë aftësimin praktik të studentëve si studiot, laboratorët dhe praktikat, krahasimisht me leksionet dhe seminarat, gjë që është në përputhje me natyrën profesionale të programit master si dhe me objektivat e programit të studimit.

- Format e kontrollit të njohurive: (Tabela 19 e Aneksve)

Sa i takon vlerësimin GVJ gjen format e ndryshme të kontrollit të dijes si: detyra kursi, projekte, punë laboratorike, teste, etj, që bën të mundur vlerësimin në të gjithë mozaikun e formimit të studentit dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit (learning outcomes) për çdo lëndë / modul.

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj: (Tabela 20 e Aneksve)

Ndonëse natyra me kohë të pjesshme e programit të studimit e bën pak më të vështirë angazhimin intensiv të studentëve, krahasimisht me ata që vazhdojnë studimet me kohë të plotë, një pjesë e mirë e studentëve në këtë program janë përfshirë në aktivitete të ndryshme të departamentit si konferenca, projekte kërkimore, mobilitet me institucione partnere, etj.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:

- (i) Rregullore e programit të studimit
- (ii) Plani mësimor
- (iii) Syllabuset

- (iv) Procesverbale të vlerësimit për lëndë / module të përzgjedhura rastësisht

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Studentët janë pjesë integrale e Universitetit POLIS. Programi i studimit MP në PZHT synon të përgatisë profesionistë të aftë për t'ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës në fushën e planifikimit të territorit.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Në Programin e Studimeve Master Profesional në Politikën dhe Zhvillimin e Territorit kualifikohen ata kandidatë që zotërojnë një diplomë Bachelor në profilet: Arkitekturë, Urbanistikë, Dizajn Urban, Planifikim dhe Menaxhim Urban, Menaxhim Mjedisor Urban, Shkenca sociale, Gjeoinformatikë apo diploma në fusha të ngjashme me këtë program studimi, që do të gjykojnë nga komisioni i posaçëm i vlerësimit të programeve në

Universitetin POLIS, apo çdo titull studimi ekuivalent fituar në vende të tjera të njohura nga autoritet zyrtare dhe ligjet në fuqi. (Neni 6, Rregullore Mësimore)

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21 e Anekseve)

Prurjet e studentëve janë të një cilësie të kënaqshme dhe cilësia e në dalje është në parametra të krahasueshëm me atë në hyrje ose në disa raste pak më e lartë. Kjo spjegohet për vetë profilin e studentëve që ndjekin këtë program studimi të cilët janë zakonisht të integruar në tregun e punës, me njohuri shumë të mira të disiplinës. Ky fakt, motivimi i studentëve që kanë një interes shumë të lartë në përthithjen e dijeve si dhe numri optimal i grupit që mundëson një punë intesive me ta janë arsytet e mesatares së mirë në dalje.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Gjatë 6 viteve të fundit janë 6 studentë të transferuar në këtë program studimi të gjithë të profilit Planifikim Hapësinor dhe Aplikime GIS.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Pothuajse 95% e studentëve të Masterit profesional janë të punësuar dhe synojnë thellimin e njohurive në këtë fushë.

Numri total i të punësuarve

Nga 87 studentë të diplomuar nga ky program studimi (Tabela 22 e Anekseve) 83 prej tyre janë në marrëdhënie pune.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<p><b>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p> <p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pranimit në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Në këtë program studimi janë regjistruar studentë të cilët kanë përfunduar me sukses studimet e ciklit të parë Bachelor ose ekuivalente me të, referuar të gjitha kriterëve të përmendura gjerësisht në pjesën përshkuese.</p> <p>Studentët e regjistruar plotësojnë kriteret e përcaktuara nga U_POLIS për regjistrimin e tyre si dhe dokumentacionin e paraqitur për regjistrim.</p> <p>Në diskutimet me stafet e U-Polis u vu re se IAL vlerëson herë pas here politikën e pranimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>
<p><b>Standardi IV.2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.</b></p>	

<p><b>Kriteri 1</b> Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Sipas dokumentacionit dhe diskutimeve në U-Polis u vu re se studentët ishin të informuar dhe merrnin informacion të përgjithshëm mbi strukturën institucionale, ofertën akademike, rezultatet e të nxëniet dhe orientimit në tregun e punës si dhe kushtet për kalimin nga një vit në tjetrin.</p> <p>GVJ konstaton që kriteret e përcaktuara në zbatim të këtij standarti përmbushen edhe përmes ngritjes, funksionimit dhe veprimtarisë së Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës.</p> <p>Kjo zyrë ishte e angazhuar me informimin e studentëve përpara dhe gjatë ndjekjes së studimeve, njohjen e tyre me tregun e punës, ndërmjetësimin e lehtësimin të procesit të punësimit, aty ku ishte e mundur.</p>
<p><b>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Nga vizita dhe kontrolli në Sekretarinë mësimore të IAL rezultoi se çdo student ka dosjen personale. Gjithashtu informacioni për çdo program studimi, është i ruajtur në hard copy dhe në mënyrë elektronike.</p> <p>Database elektronik është i ruajtur dhe i siguar sipas elementëve të sigurisë nëpërmjet sistemit të backup.</p> <p>Sekretaria mësimore çdo vit përgatit të dhëna statistikore lidhur me regjistrimet e studentëve, transferimet, çregjistrimet e tyre si dhe diplomimin. Këto statistika dërgohen në drejtorinë e Statistikave në MAS, njëkohësisht edhe Departamentit përkatës, i cili është përgjegjës për programin e studimit.</p> <p>Vlerësimet/notat e studentëve ruhen elektronikisht (regjistri elektronik i notave), njëkohësisht plotësohet edhe regjistri fizik i notave.</p>
<p><b>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Gjatë vizitës në U-Polis, GVJ u informua se institucioni disponon, mban dhe përditëson edhe nëpërmjet ZMSKK statistikat e punësimit për studentët që kanë përfunduar studime. Kjo ishte e paraqitur edhe në dokumentacionin përkatës.</p>
<p><b>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Nga të dhënat e marra gjatë vizitës në institucion, vrojtimit të botimeve në Bibliotekë, verifikimit të faqes web dhe bisedave me studentët rezultoi se studentët informohen në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme mbi programet e studimit dhe modulet përkatëse nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informacionit si gazeta informative, materiale të botuara (broshura; fletëpalosje); materialeve elektronike të aksesueshme në faqen zyrtare të U POLIS dhe mediave sociale si Facebook.</p>

	Përfaqësues të studentëve janë të përfaqësuar në organet më të larta drejtuese të U_POLIS, si Senati Akademik, ashtu dhe në Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, në këtë mënyrë ata janë pjesë e vendimmarrjes si dhe në dijeni të plotë të zhvillimeve që i përkasin cilësisë së Universitetit.
<b>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;	Per këshillimin e studentëve janë caktuar persona përgjegjës lidhur për ecurinë e procesit akademik dhe përmes shërbimit të tutoratit që zakonisht e ofrojnë menaxherët e kurrikulës.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.	Mundësinë për kryerjen e praktikës profesionale, IAL e ofron nëpërmjet dy partnerëve të vet strategjikë Co-PLAN e Metro_POLIS, por dhe nëpërmjet rrjetit të partnerëve.
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. IAL plotëson standardet që lidhen me pranimin e studentëve, cilësinë e ofertës akademike, kujdesin për aksesin ndaj të gjitha shërbimeve, teknologjive të informimit si dhe cilësinë e shërbimeve ndaj tyre.</li> <li>2. Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe nga bisedat me studentët GVJ konstaton që ata marrin informacion për akreditimin e institucionit dhe programeve të studimit si dhe janë të informuar për vlerën e diplomës si në tregun e brendshëm ashtu edhe atë të jashtëm të punës.</li> <li>3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës në mënyrë që ata të marrin informacione të vazhdueshme mbi tregun e punës dhe të orientohen sa më mirë për të zënë pozicione që u përgjigjen kualifikimit të tyre.</li> <li>4. GVJ konsultoi gjithë dokumentacionin që lidhej me statistikat vjetore të të rregjistruarve, diplomuarve, punësuarve, shembujve të suksesit etj dhe konstaton që ky dokumentacion përdoret në interes të rritjes së cilësisë së aktiviteteve në institucion.</li> <li>5. Institucioni tregon një angazhim maksimal për ta afësuar studentin në procesin e mësimdhënies për ta orientuar sa më mirë atë nëpërmjet të tutoratit dhe për ta mbështetur atë në tregun e punës.</li> </ol>	

## KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### 10. Kërkimi shkencor

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Kërkimi shkencor vlerësohet të luaj rol të rëndësishëm në Universitetin POLIS. Institucioni harton në mënyrë periodike Axhendën e Kërkimit Shkencor ku duke ndjekur Strategjinë e Zhvillimit, detajohen fushat e interesit të kërkimit shkencor të institucionit, sipas fakulteteve dhe departamenteve. Ky dokument shërben si bazë për politikat e kërkimit shkencor në institucion. Universiteti POLIS nxit dhe mbështet kërkimin shkencor të personelit akademik nëpërmjet programeve të brendshme, programeve të përbashkëta, projekteve ndërkombëtare dhe financimeve direkte. Rezultatet e kërkimit shkencor vlerësohen nga institucioni, shpërndahen nëpërmjet publikimeve dhe shërbejnë për rritjen e kapacitetit në vend, për zhvillimin e inovacionit në industri dhe për përditësimin e përmirësimin e mësimdhënies.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor

Bazuar në deklarinimin e institucionit si dhe në verifikimet e kryera gjatë vizitës në institucion rezultoi se institucioni është shumë i perkushtuar ndaj kërkimit shkencor në të gjitha nivelet, stafi individualisht, departamentet por dhe në nivel ndër-departmental siç na u shpjegua gjatë takimit me Innovation Factory. Kërkimi shkencor dhe ai i aplikuar kryhet nëpërmjet një morie aktiviteteve si konferenca, simpoziume, seminare, projekte kërkimore, publikime, etj. (Të dhëna të detajuara jepen në tabelat 23 dhe 24 të Aneksëve)



Është për tu theksuar dimensionin ndërkombëtar i kërkimit (programi i doktoratës, organizimi i konferencave ndërkombëtare, publikime ndërkombëtare dhe në gjuhë të huaj, etj)

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<p><b>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b></p> <p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Personeli akademik kryen vazhdimisht aktivitete të lidhura me kërkimin shkencor dhe në saj të këtij aktiviteti publikon rregullisht artikuj dhe materiale shkencore në disiplinën e fushës përkatëse. Publikimet e artikujve dhe materialeve shkencore nxiten, maten dhe vlerësohen nga institucioni. Publikimet dhe pjesëmarrja në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare nxiten dhe mbështeten në disa mënyra nga institucioni. Konkretisht Universiteti POLIS është botues i revistës shkencore "Forum A+P" i njohur nga MASR dhe i pajisur me ISSN ndërkombëtare. Në këtë periudhë, i cili botohet prej vitit 2007, personeli akademik mund të publikojë, pas reçencës, rezultatet e kërkimit shkencor. Departamentet në Universitetin POLIS miratojnë çdo vit akademik buxhetin e tyre për kërkimin shkencor ku parashikohen edhe pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare. Ky aspekt konsiderohet i rëndësishëm pasi vetë departamentet arrijnë të parashikojnë dhe të mbulojnë një pjesë të mirë të shpenzimeve që rrjedhin nga kërkimi shkencor në nivel individual dhe departamenti. Mënyrë tjetër e nxitjes së personelit akademik për të publikuar rregullisht është organizimi prej Universitetit POLIS, i vetëm ose në bashkëpunim me institucione partnere vendase apo të huaja të konferencave shkencore dhe simpoziumeve. Këto aktivitete janë mundësi shumë të mira ku personeli akademik mund të ekspozojë dhe publikojë rezultatet e kërkimit shkencor para një komuniteti të gjerë kërkuesish.</p> <p>Përveç nxitjes, publikimet dhe rezultatet e kërkimit shkencor maten nga institucioni. Personeli akademik parashikon çdo vit, nëpërmjet aneks kontratës, sasinë e kohës që do i kushtohet kërkimit shkencor. Në fund të vitit akademik, personeli deklaron rezultatet e kërkimit si dhe numrin e publikimeve dhe pjesëmarrjeve në konferenca. Çdo rezultat i kërkimit vlerësohet me pikë sipas koeficientëve përkatës dhe në fund të vitit hartohet një raport mbi kërkimin shkencor në Universitetin POLIS, ku behet një vlerësim me pike si në nivel individual ashtu edhe në nivel departamenti. Këto vlerësime shërbejnë për të plotësuar vlerësimin 360° që kryhet për personelin akademik duke ju bashkuar vlerësimin të studentëve, vetëvlerësimin dhe vlerësimin nga kolegët.</p> <p>Kërkimi shkencor i kryer nga personeli akademik i Universitetit POLIS shërben në përparimin e shkencës në vend dhe në nxitjen e inovacionit në industri dhe shërbime. Mund të përmenden këtu seria e publikimeve ndërkombëtare të kërkimeve të realizuara nga njësisia kërkimore "Observatory of Mediterranean Basin", publikimi i librit të Dr. Antonino Di Raimo "Heretical Machinism and Living Architecture of New Territories.com". Për më tepër,</p>

	<p>pjesëmarrja në konsorciumet ndërkombëtare të kërkimit, lejon venin që të jetë i përfaqësuar në disa rrjete institucionesh kërkimore.</p>
<p><b>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Universiteti POLIS ofron disa lëndë apo module ku pedagogët janë të huaj. Këta, në përgjithësi, vijnë prej institucioneve partnere europiane apo amerikane. Personeli i huaj i angazhuar sjell eksperiencë ndërkombëtare në mësimdhënie.</p> <p>Mësimi në këto raste zhvillohet në gjuhën Angleze ndërsa personeli vendas asiston në mbarëvajtjen e lëndës apo modulit.</p>
<p><b>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Universiteti POLIS nxit specializimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të personelit nëpërmjet një politike që artikullohet në disa iniciativa nga të cilat mund të përmenden trajnimet brenda institucionit të organizuara në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtar, ndër të cilët një vend të rëndësishëm zë cikli i trajnimeve të mbështetura nga Qeveria Hollandeze, MATRA.</p> <p>Përveç cikleve të trajnimeve, Unversiteti POLIS ka organizuar dy programe të ciklit të tretë MND. Një pjesë e rëndësishme e pjesëmarrësve në këto programe ka qenë personel i brendshëm i Universitetit POLIS.</p> <p>Universiteti POLIS organizon gjithashtu programin e Përbashkët Ndërkombëtar të Doktoraturës në Arkitekturë dhe Planifikim Urban në bashkëpunim me Universitetin e Ferrarës, Itali. Ky program lejon zhvillimin dhe thellimin e mëtejshëm të njohurive të personelit akademik.</p> <p>Ndërkohë personeli i angazhuar në programe doktorature pranë institucioneve të tjera ndërkombëtare nxitet të përfundojë me sukses studimet.</p> <p>Falë pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare të kërkimit dhe zhvillimit, personeli akademik dhe administrativ mund të marrë pjesë në periudha mobiliteti ndërkombëtar me kohëzgjatje prej 1 jave deri në 6 muaj pranë universiteteve partnere si për shembull Universiteti Erasmus në Hollandë, U_Minho në Portugali, Universiteti Politeknik i Barit, Universiteti i Molise, Universiteti i Bolonjas në Itali etj.</p>
<p><b>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon një bazë të</p>	<p>Personeli akademik i Universitetit POLIS deklaron në fund të çdo viti akademik aktivitetin e lidhur me kërkimin dhe studimin shkencor, botimet, pjesëmarrjet në konferenca si dhe pjesëmarrjet në projekte kërkimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Ky deklaram përveçse shërben për vlerësimin dhe promovimin e personelit akademik, shërben edhe për krijimin e një baze të dhënash për të gjitha studimet shkencore, publikimet dhe projektet kërkimore të zhvilluara</p>

dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.

nga personeli i Universitetit POLIS.

Falë kësaj baze të dhënash hartohet një raport i përvitshëm ku përmbledhen aktivitetet shkencore. Çdo produkt i kërkimit shkencor vlerësohet sipas një sistemi pikësimi *Benchmark System* dhe dokumentohet e arkivohet. Çdo vit akademik, rezultatet e punës kërkimore dhe gjetjet e vlerësimit benchmark prezantohen dhe diskutohen në një ëorkshop të kushtuar kërkimit shkencor ku merr pjesë i gjithë personeli akademik.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Personeli akademik i Universitetit POLIS nxitet dhe merr pjesë rregullisht në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programeve të studimit si dhe në kuadër institucional ose ndërkombëtar. Pjesëmarrja në këto aktivitete financohet nga institucioni nëpërmjet fondeve të departamenteve dhe sjell si rezultat publikime dhe nxitjen e kërkimit shkencor e të aplikuar në vend. Konsiderohet pozitiv fakti që rezultatet e kërkimit shkencor janë pjesë e vlerësimit të performancës vjetore 360° të personelit akademik.
2. Lëndët apo modulet që drejtohen nga pedagogë të huaj të ftuar nga institucione partnere zhvillohen në gjuhën Angleze ndërsa personeli vendas asiston në mbarëvajtjen e lëndës apo modulit.
3. Universiteti POLIS angazhohet në kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit nëpërmjet trajnimeve të brendshme, programit ndërkombëtar të doktoraturës së vetë institucionit, mbështetjes në ndjekjen e programeve të doktoraturës jashtë institucionit si dhe pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare kërkimi dhe mobiliteti në institucione partnere.
4. Institucioni mban një bazë të dhënash mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik. Kjo bazë të dhënash përditësohet çdo vit akademik nëpërmjet deklarimit nga personeli akademik të studimeve shkencore, publikimeve dhe pjesëmarrjeve në projekte kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare. Baza e të dhënave shërben edhe për të vlerësuar produktin e kërkimit shkencor sipas një sistemi pikësimi.

#### **11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Bazuar në RVB dhe analizën SËOT të vetë U\_POLIS, kjo evidentohet si një pikë e fortë e institucionit në tërësi por dhe e programit konkretisht.

Sasia dhe larmia e marrëveshjeve të bashkëpunimit me organizma publikë dhe privatë, universitete vendase dhe të huaja ka mundësuar që U\_POLIS të këtë një portfolio të pasur me aktivitete të kryera në bashkëpunim me institucione partnere.

Në mënyrë të veçantë evidentohen projektet kërkimore dhe për ngritjen e kapaciteteve (multilaterale dhe bilaterale) të financuara nga BE. GVJ gjen 14 projekte të tilla në të cilat, U\_POLIS është aktualisht i përfshirë.

##### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
  - Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare
  - Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj
  - Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit
  - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL
  - Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor
  - Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime

Të dhëna të detajuara jepen në Tabelat 25, 26 dhe 27 të Anekseve.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- Marrëveshjet e Bashkëpunimit
  - Statistika për projektet
  - Inspektim fizik i laboratorëve

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, Universiteti POLIS ka një sërë marrëveshjesh efektive të cilat dëshmojnë marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha të tregtisë, industrisë apo shërbimeve prodhuese.</p> <p>Marrëveshje bashkëpunimi janë lidhur si me organizma publikë ashtu dhe privatë, ku studentët kryejnë praktikat mësimore.</p>
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Kryesisht koordinimi i kërkimit kryhet në nivel departamenti, ku sic na u shpjegua, stafi në një ëorkshop të përvitshëm harton në mënyrë kolegjiale Axhendën Kërkimore, e cila më pas përkthehet në një plan individual që i bashkëngjitet kontratës. Në përfundim të vitit akademik stafi raporton në departament për realizueshmërinë e planit kërkimor, për të cilin dhe vlerësohet nga NJSBC.</p> <p>Gjatë takimeve u vu re se stafi është i prirur të shkëmbejë ide dhe mendime për punë dhe projekte kërkimore, të ndajë të rehat në fusha me interes të përbashkët, madje krahas takimeve të përcaktuara në kalendarin vjetor të Universitetit, kjo frymë bashkëpunimi tashmë ndjehej natyrshëm si pjesë e aktivitetit të përditshëm të stafit.</p> <p>Në raste projektesh ndërdisiplinore, njësia përgjegjëse për koordinimin ishte Innovation Factory.</p>
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Universiteti POLIS disponon një numër të konsiderueshëm Marrëveshjesh Bashkëpunimi me Universitete homologe të rajonit, evropiane dhe më tej, gjë që i mundëson stafit por edhe studentëve të jenë pjesë e mobiliteteve, trajnimeve, pjesëmarrjes në Konferenca dhe evente të rëndësishme ndërkombëtare.</p> <p>Vetë organizimi i masterave profesional në bashkëpunim me Universitete evropiane apo dhe program i përbashkët i doktoraturës, e bën më të prekshëm bashkëpunimin dhe përfitimin në terma realë.</p> <p>Ndërkohë Universiteti POLIS bashkëpunon ngushtë me komunitetin e biznesit si dhe institucionet publike për organizimin e seancave dëgjimore, konferenca apo trajnime të përbashkëta.</p>

Nga lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit, depozituar nga Universiteti në kuadër të RVB, janë përzgjedhur në mënyrë rastësore disa prej tyre, ku vihet re realizimi dhe përdorimi efektiv që vjen nga këto marrëveshje sa i përket internshiptit të studentëve, mobiliteteve apo pjesëmarrjes së palëve në aktivitete të ndryshme të organizuara nga Universiteti POLIS.

### Konkluzionet e vlerësimit:

1. Universiteti POLIS ka një sërë marrëveshjesh të cilat dëshmojnë marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha të tregëtisë, industrisë apo shërbimeve prodhuese. Ky bashkëpunim i ndërsjelltë u mundëson studentëve praktika/ intership cilësor duke u mundësuar atyre që njohuritë teorike ti integrojnë në tregun e punës.
2. Universiteti në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit, nëpërmjet këtyre marrëveshjeve ka ditur ti vërë në shërbim të objektivave të vendosura dhe të përgatisë më së miri studentët për sfidat por dhe risitë e tregut të punës.
3. Fryma mjaft pozitive e bashkëpunimit mes personelit është një nga pikat e forta të Universitetit POLIS, gjë që reflektohet në nisma të përbashkëta të personelit në projekte kërkimore, botime, Konferenca shkencore por dhe për një jetë të shëndetshme sociale.
4. Universiteti POLIS bashkëpunon intensivisht me institucione homologe të rajonit, evropiane por dhe më tej dhe kjo i mundëson stafit por edhe studentëve të jenë pjesë e mobiliteteve, trajnimeve, pjesëmarrjes në Konferenca dhe evente të rëndësishme ndërkombëtare. Nga ana tjetër një qasje e tillë e strategjisë së ndërkombëtarizimit natyrshëm e pozicion Universitetin POLIS në hartën e Universiteteve më në zë evropiane.

## **ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Analiza përmbledhëse e RVJ sipas metodës SWOT (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat).

### **a. Pika të Forta:**

1. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe verifikimet gjatë vizitës së monitorimit u konstatua përmbushja e të gjithë rekomandimeve të lëna nga ekspertët e vlerësimit të jashtëm gjatë akreditimit në 2013.
2. Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe adreson nevojat e tregut të punës. Programi është i hartuar në përputhje me nivelin e studimit dhe ka objektiva formimi të mirëartikulluar.
3. Ky program ka statusin e një programi të përbashkët studimi pasi ofrohet në bashkëpunim mes Universitetit POLIS dhe IHS – Institute for Housing and Urban Studies / Erasmus University, Hollandë, dhe si i tillë arrin formën më të lartë të ndërkombëtarizimit duke ofruar/lëshuar diplomë të përbashkët e të bashkë-nënshkruar nga të dy institucionet.
4. Një aspekt që ka pësuar përmirësim dhe rritje sasiore e cilësore krahasimisht me akreditimin fillestar janë laboratorët dhe biblioteka dhe materialet studimore në shërbim të programit të studimit.
5. U\_POLIS ka tashmë një sistem të ngritur e funksional të sigurimit të brendshëm të cilësisë, por dhe një përvojë shumë të mirë me procese të jashtme të vlerësimit të cilësisë fituar nëpërmjet akreditimit institucional (me vlerësim shumë të lartë dhe nga procesi i fundit kryer nga QAA dhe ASCAL), por dhe me akreditim ndërkombëtar për disa nga programet e studimit.
6. Një nga aspektet pozitive të konstatuara (e vlerësuar dhe nga vetë studentët) ishin metodat e larmishme të mësimdhënies dhe pajisja e studentëve jo vetëm me njohuri teorike por dhe aftësi praktike e aplikative.
7. U\_POLIS ka dëshmuar një përkushtim të qartë ndaj kërkimit shkencor, reflektuar kjo në portfolion e pasur të projekteve dhe aktiviteteve kërkimore, ku krahas stafit, angazhohen sipas rastit dhe studentët.
8. U\_POLIS ka ndërtuar një rrjet të gjerë partnerësh kombëtare e ndërkombëtarë që mundëson jo vetëm një burim informacioni për përmirësimin e kurrikulës, por dhe organizimin e një sërë aktivitetesh e projekteve, si dhe praktika mësimore e intership për studentët. Shkalla e ndërkombëtarizimit është

shumë e lartë si në nivel institucional por dhe programor, reflektuar kjo në përmbajtjen e kurrikulës, stafin ndërkombëtar të angazhuar dhe numrin në rritje të mobilitetit të stafit dhe studentëve.

**b. Afirmime:**

1. Mbështetet institucioni në qëllimin e tij për të përshtatur rolin e zyrës së karrierës në lidhje me këtë program studimi. ZMSKK e ka fokusuar gjurmimin e të diplomuarve me të dhëna për punësimin e tyre. Duke qenë se në këtë program studimi, një pjesë e mirë e studentëve janë të punësuar që përpara regjistrimit, ngelet si detyrë gjurmimi i avancimit të tyre në karrierë pas diplomimit nga ky program.

**c. Mundësitë:**

1. Investimet në laboratore, pasurimi i bibliotekës dhe metodat bashkëkohore të mësimdhënies pritet të kontribuojnë në rritjen e mëtejshme të cilësisë së programit, gjë që do çojë në rrijen e mëtejshme të të regjistruarve për të tre profilet.
2. Mobilizimi i U\_POLIS për të qenë pjesë e projekteve të financuara nga BE që mundësojnë mobilitetin e stafit dhe të studentëve, pritet të kontribuojnë për rritjen e atraktivitetit të programit duke rezultuar në rritje të sasisë dhe cilësisë së të regjistruarve për të tre profilet.

**d. Pengesat:**

1. Rënia demografike dhe largimet/emigrimet në masë të grupmoshës 18-35, kanë sjellë një rënie të përgjithshme të numrit të kandidatëve potencial për studimet universitare dhe profesionale. Kjo situatë mund të sjellë edhe uljen e numrit të aplikantëve në këtë program studimi.

## SUMMARY ANALYSIS OF THE STUDY PROGRAM IMPLEMENTATION

### Comprehensive analysis of the EER according to the SWOT method (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats).

**a. Strengths:**

1. Based on the submitted documentation and verifications made during the monitoring visit, the fulfillment of all recommendations left by external evaluation experts during the initial accreditation in 2013 was noted.
2. The Study Program is designed in accordance with the institution's development strategy and addresses the needs of the labor market. The program is designed in accordance with the level of study and has well articulated training objectives.
3. This program has the status of a joint study program as it is offered in collaboration between POLIS University and IHS - Institute for Housing and Urban Studies / Erasmus University, Netherlands, and as such achieves the highest form of internationalization by offering / issuing a joint degree, co-signed by both institutions.
4. Another aspect that has improved and increased quantitatively and qualitatively in comparison to the initial accreditation, are laboratories and libraries and study materials at the service of the study program.
5. U\_POLIS already has an established and functional internal quality assurance system, but also a very good experience with external quality evaluation processes obtained through institutional accreditation (with very high rating also at the latest process conducted by QAA and QAAHE), but also with international accreditation for some of the study programs.
6. One of the noted positive aspects (evaluated by the students themselves) was the diverse teaching methods and equipment of students not only with theoretical knowledge, but also practical and applicative skills.
7. POLIS has demonstrated a clear commitment to scientific research, reflected in the rich portfolio of projects and research activities, where in addition to staff, students are also involved as appropriate.
8. U\_POLIS has built up a wide network of national and international partners that enables not only a source of information on curriculum improvement, but also organizing a variety of activities and projects as well as learning and internship practices for students. The degree of internationalization is

very high as at the institutional level but also at programmatic one, reflected in the curriculum content, the international staff engaged and the increasing number of staff mobility and students.

**b. Affirmation:**

1. Is supported the Institution's goal to adapt the role of the career office in regard to this study program. The Student Support Office for Career Counseling has focused tracking of graduates on data for their employment. Since in this study program, a good part of the students are employed before the census, their career advancement can be tracked only after graduation from this program.

**c. Opportunities:**

1. Investments in laboratories, enrichment of the library and contemporary teaching methods are expected to contribute to a further quality improvement, resulting in a further increase of the enrolled students for the three profiles.
2. U\_POLIS mobilization to be part of EU-funded projects that enable staff and student mobility are expected to contribute to increase program attractiveness resulting in an increase of quantity and quality of the enrolled students for the three profiles.

**d. Threats:**

1. Demographic decline and mass outbreaks / emigration of the age group 18-35 have led to a general fall in the number of potential candidates for university and professional studies. This situation can also lead to a reduction in the number of applicants in this study program.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

Prof. As. Gafur Muka  
Dr. Gjergj Thomai

